


Prospekt



CREDINS
PREMIUM

PROSPEKT

Fondi i Investimit “Credins Premium”

Miratur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:

Vendimi nr. 144, Datë 30.08.2021

Publikuar në Shtator 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

Informacion i rëndësishëm.....	6
Përkufizime.....	7
Të dhënat e shoqërisë administruese.....	10
Objekti i aktivitetit.....	10
Fondet nën administrimin e shoqërisë Credins Invest sh.a.....	11
Përbërja e organeve drejtuese të shoqërisë administruese.....	11
Asambleja e aksionarëve.....	11
Këshilli i administrimit.....	11
Administrimi.....	12
Personeli kyç.....	12
Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese.....	13
Konflikti i interesit.....	13
Të dhënat e përgjithshme të fondit.....	14
Koncepte të përgjithshme mbi fondin.....	14
Fondi i investimit “Credins Premium”.....	14
Shuma minimale e investimit.....	14
Dokumentacioni i fondit “Credins Premium”.....	15
Informacion për investitorët.....	15
Objektivi i investimit të fondit.....	16
Politika e investimit.....	16
Duration (kohëzgjatja).....	18
Faktorët e rrezikut.....	18
Informacion i përgjithshëm.....	18
Karakteristikat e rrezikut të aseteve në fond.....	19
Depozitat në institucionet e kreditimit.....	19
Obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë.....	19
Obligacionet dhe bonot korporative.....	20
Obligacionet dhe bonot e organeve vendore të republikës së shqipërisë.....	20
Kuota të fondeve të investimeve të liçensuar nga AMF.....	20
Rating-u i kreditit dhe instrumentat që nuk kanë “rating”.....	20
Rreziqe të lidhura me investimin.....	20
Rreziku i tregut.....	20
Rreziku nga normat e interesit.....	21
Rreziku i kursit të këmbimit.....	21
Rreziku i kredisë.....	21
Rreziku i likuiditetit.....	21
Rreziku i shlyerjes.....	21
Rreziku i palës tjetër.....	21
Rreziku i përqëndrimit.....	22
Rreziku i performancës.....	22
Rreziku i shlyerjeve të mëdha.....	22
Rreziku i vlerësimit të aseteve.....	22
Rreziku i inflacionit.....	22
Rreziku i agjencisë.....	22
Rreziku i depozitarit.....	22
Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave.....	22
Rreziku politik.....	23

Rreziqe të tjera.....	23
Rreziku operacional.....	23
Rreziku ligjor.....	23
Rreziku rregullator.....	23
Rreziku i personave dhe personelit kyç.....	23
Rreziku nga delegimi i disa funksioneve.....	23
Parimet për ekzekutimin më të mirë të mundshëm.....	24
Përshkrim i përgjithshëm.....	24
Kriteret e ekzekutimit.....	24
Përzgjedhja e partnerëve (ndërmjetësve) të tregtimit.....	24
Përzgjedhja e vendeve të tregtimit.....	24
Konflikti i interesit.....	25
Rishikimi i parametrave themelore.....	25
Të dhëna të tregjeve të rregulluara.....	25
Administrimi i fondeve.....	26
Përlllogaritjet dhe frekuenca e vlerësimit të aseteve, vlerës neto të aseteve dhe çmimit.....	26
Asetet që tregtohen në treg aktiv.....	26
Asetet që tregtohen në treg joaktiv.....	27
Vlera neto e aseteve dhe çmimi.....	27
Komisionet dhe shpenzimet.....	28
Komisione hyrëse dhe dalëse të njehershme.....	28
Komisione/tarifa të vazhdueshme që paguhen nga fondi.....	28
Tarifa e administrimit.....	28
Komisione/ tarifa që paguhen nga investitori.....	29
Trajtimi fiskal.....	29
Blerja e një kuote.....	30
Administrimi i pjesës së fitimit për mbajtësit e kuotave.....	31
Të drejtat dhe detyrimet nga kuotat.....	31
Shlyerja e kuotave.....	31
Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondit.....	32
Këmbimi i kuotave.....	33
Vdekja e anëtarit.....	33
Mbyllja e fondit.....	33
Rrethanat e mbylljes.....	33
Procedurat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen e fondit.....	34
Depozitari.....	34
Konflikti i interesit.....	36
Audituesi.....	36
AMF.....	36
Viti financiar.....	36
Informacion Plotësues.....	37

PROSPEKT

INFORMACION I RËNDËSISHËM

Ky Prospekt përmban informacion në lidhje me Fondin e Investimit “CREDINS PREMIUM”, të quajtur në vijim “Fondi”, i menaxhuar nga shoqëria CREDINS INVEST sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve, me një eskperiencë të konsoliduar disavjeçare në tregun e investimeve në Shqipëri, në vijim “Shoqëria Administruese”.

Fondi i Investimit “CREDINS PREMIUM” është fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike i emetuar në monedhën lek. Ky fond përbën një mundësi investimi për të gjithë investitorët individ apo institucional që kërkojnë kthime nga investimi i tyre në monedhën lek. Politika e investimit të fondit, paraqitur në këtë prospekt është në përputhje me objektivat e fondit dhe me profilin e riskut të investitorit të fondit.

Prospekti i drejtohet të gjithë investitorëve të mundshëm të fondit dhe ka për synim informimin e saktë dhe të plotë të tyre përpara investimit në fond. Investitorët duhet të lexojnë plotësisht prospektin dhe të konfirmojnë që e kanë kuptuar atë. Nëse ka paqartësi në lidhje me përmbajtjen e prospektit investitorët mund të këshillohen me personat e autorizuar për shpërndarjen e tij.

Shoqëria Administruese ofron mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve të investimit në bazë të informacionit të shfaqur në këtë dokument. Asnjë person nuk është i autorizuar për të dhënë informacion apo për të riparaqitur përveç personave të përcaktuar në këtë prospekt. Në rast se ky informacion është riparaqitur nga persona të paautorizuar, atëherë ky informacion nuk duhet marrë për bazë.

Përpunuesit e prospektit kanë treguar kujdes të arsyeshëm që informacioni në prospekt të jetë i saktë dhe mungesa e ndonjë informacioni nuk ka pasoja materiale mbi rezultatin e pjesëmarrjes në Fond. Shoqëria Administruese është e përgjegjshme për sa më lart.

Prospekti nuk përbën një ftesë për të blerë kuota të Fondit por shërben si një mjet informativ lidhur me tiparet, karakteristikat dhe rreziqet e lidhura me pjesëmarrjen në fond. Investitorët udhëzohen të lexojnë këtë Prospekt në mënyrë që të kenë një panoramë të qartë mbi veçoritë dhe rreziqet tek të cilat është i ekspozuar fondi përpara se të marrin vendimin për të investuar në këtë fond.

Ky prospekt mund të përkthehet në gjuhë të tjera, duke u siguruar që është një përkthim direkt nga gjuha shqipe, dhe në rast mospërputhje, versioni në gjuhën shqipe mbizotëron. Të gjitha mospërputhjet janë të rregulluara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Investitorët mund të zgjedhin të investojnë në një apo në disa fonde të menaxhuara nga Shoqëria Administruese. Investitorët zgjedhin fondin që përshtatet me tolerancën e tyre për rrezik, dhe janë të inkurajuar të marrin këshilla të pavarura financiare për këtë vendim. Vlera neto e aseteve dhe performanca e fondeve priten të ndryshojnë nga njëra-tjetra.

Investitorët në fond janë të ekspozuar ndaj rrezikut që mbartin asetet në fond. Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht, pasi në situata tregu të tensionuara apo të jashtëzakonshme investitori mund të humbasë kapital për periudha kohore të shkurtra ose të gjata, por rreziku mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e përshtatshme për administrimin e tij. Investimi në Fond nuk konsiderohet si depozitë bankare, dhe si i tillë nuk sigurohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).



PËRKUFIZIME

“AMF” - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, krijuar në përputhje me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, është autoriteti i cili, sipas ligjit ose akteve nënligjore në fuqi, regjistron dhe/ose licencon e mbikëqyr sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqëritë administruese, depozitarin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

“Alokimi Strategjik” nënkupton pjesën që zë çdo klasë asetë në portofolin e investimeve.

“Asete” janë letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, në pronësi të anëtarëve në fond.

“Depozitar” nënkupton Bankën Depozitare, një bankë e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer si veprimtari ruajtjen e pasurisë së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe e cila ka detyrat dhe funksionet e parashikuara të Ligjit Nr. 56/2020, datë 30.04.2020, si dhe aktet nënligjore të dala nën zbatim të tij.

“Diversifikim i portofolit” investim i asetëve të Fondit në klasa të ndryshme instrumentesh financiare me qëllim zvogëlimin e rrezikut të portofolit.

“Fondi i investimeve” është sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar me kontratë si grupim i veçantë aktivesh, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fond.

“Fond i investimeve alternative (FIA)” është sipërmarrja e investimeve kolektive, përfshirë edhe nënndarjet ose nënfondet e investimit të saj, e cila siguron kapital nga një numër investitorësh, me qëllim investimin e tij në përputhje me një politikë të përcaktuar investimi për realizimin e përfitimeve për investitorët dhe që nuk licenohet si sipërmarrje e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, sipas këtij ligji

“Fitimi/humbja nga rivlerësimi kapitalit” ndodh kur norma e interesit të letrës me vlerë me të ardhura fikse ndryshon, dhe për rrjedhojë ndryshon dhe çmimi duke rezultuar në fitim apo humbje. Lidhja e zhdrejtë midis normës së interesit dhe çmimit, bën që kur norma e interesit të ulet, të kemi një fitim nga rivlerësimi, dhe kur norma e interesit të rritet të kemi një humbje nga rivlerësimi.

“Investitor” është subjekti, që ka në pronësi kuota në një fond investimi.

“Instrumente Derivative” janë instrumenta financiare vlera e të cilave varet nga vlera e asetëve të tjera si obligacioneve, aksioneve, commodities etj. Instrumenta derivatitë janë optionet, këmbesat (swaps), kontratat e ardhme etj.

“Kuotë” është çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfitues në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

“Kuota akumulimi” janë kuotat e një fondi, për të cilat të ardhurat nga investimi riinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.

PROSPEKT

“Ligji Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, i referohet Ligjit Nr. 56/2020, datë 30.04.2020 i cili rregullon themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese dhe të depozitarëve.

“Marrëveshje e riblerjes” (Repo) marrëveshje për shitjen e instrumentave financiare dhe riblerjen e tyre në një afat të shkurtër, me një çmim më të paracaktuar.

“Marrëveshje e anasjelltë riblerjes” marrëveshje për blerjen e letrave me vlere dhe rishitjen e tyre në një kohë dhe çmim të paracaktuar.

“Personel kyç” janë personat fizikë në poste të larta, të cilët janë përgjegjës për funksionet kyç të shoqërisë administruese.

“Portofol asetesh” tërësia e investimeve të kryera me asetet e fondit.

“Prospekt” është dokumenti i bërë publik, i cili shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet për të qenë pjesë e SIK. Në përmbajtje të tij gjenden informacione të rëndësishme për investitorin si politika e investimit, politika e administrimit të riskut, tarifatat që i ngarkohen investitorit.

“Rregullat e fondit” janë dokumentet kryesore, që rregullojnë krijimin e fondit të investimeve, ku përfshihen marrëveshja e administrimit dhe marrëveshja me depozitarin.

“Sipërmarrje investimesh kolektive, SIK” është forma e organizimit qëllimi i së cilës është mundësia e personave që marrin pjesë në këtë formë organizimi (“pjesëmarrësit”), të bëhen pronarë të pasurisë ose të një pjese të saj, të përfitojnë fitime ose të ardhura që rrjedhin nga marrja, mbajtja, administrimi ose shitja e pasurive ose shumave të paguara nga këto fitime ose të ardhura dhe pjesëmarrësit nuk kanë kontroll të përditshëm mbi aktivet, llogaria e pjesëmarrësve përbëhet nga kontributet dhe fitimet, pasuria l përket investitorëve dhe administrohet nga shoqëria administruese .

“Shoqëria Administruese” nënkupton Shoqërinë Administruese të Fondeve e krijuar si shoqëri aksionare, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare e licencuar nga AMF për të administruar fonde investimi, fonde pensioni vullnetar dhe fonde të investimeve alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

“Shoqëri komandite” Shoqëria Komandite është një shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

“Standard i Përbashkët i Raportimit” (CRS) kërkon që institucionet financiare të një juridiksioni raportues, me qëllim shmangien e evazionit fiskal, të mbledhin dhe raportojnë informacion tek autoritetet e tyre tatimore në lidhje me mbajtësit e llogarive të cilët janë rezidentë të shteteve të tjera.

“Tarifa e Administrimit” nënkupton komisionin e menaxhimit të aseteve që i paguhet Shoqërisë Administruese, e shpjeguar tek seksioni Komisionet dhe Tarifatat.

“Tituj të borxhit” janë instrumente financiare që emetohen nga shoqëri tregtare private ose institucione qeveritare, dhe tregtohen për sigurimin e fitimit nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre.



FONDI I INVESTIMIT CREDINS PREMIUM

“Treg i rregulluar” është sistemi shumëpalësh cili bashkon interesat e shitblerjes të instrumente financiare, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij dhe i licencuar, regjistruar apo njohur nga AMF. Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emetuar dhe garantuar nga Qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë, me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

“Treg Aktiv” është tregu në të cilin transaksionet për asetet kryhen me frekuencë të mjaftueshme dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme sipas përcaktimit të rregullores nr. 2, datë 27.01.2021 *“Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët”*.

“Treg jo-aktiv” është tregu në të cilin transaksionet e aseteve nuk kryhen në frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm sipas kriterëve të nenit 26 dhe nenit 27 të rregullores nr. 2, datë 27.01.2021 *“Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët”*.

“Vlera neto e aseteve” është vlera e agreguar e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive (ose Fondit) pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e llogaritjes.

“Vlera neto e aktiveve për kuotë” është vlera neto e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive (ose Fondit) e pjesëtuar me numrin e kuotave në emetim në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

PROSPEKT

TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese:	Credins Invest sh.a, shoqëri Administruese e Fondeve.
Themelimi:	Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit, Tiranë Nr. 34260, me datë 31 tetor 2005. Afati i pacaktuar.
Kapitali aksionar:	76% për qind të aksioneve ose të së drejtës së votës janë në pronësi Bankës Credins sh.a. Kapitali aksionar i regjistruar i Shoqërisë Administruese është 95,822,394 Lekë.
Forma ligjore:	Shoqëri Aksionare
Mbikëqyrja:	CREDINS INVEST sh.a. mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe ligjit nr. 56/2020 datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.
Adresa:	Rr. Nikolla Tupe, nr.1, Kati III, Tiranë, Shqipëri
Website:	www.credinsinvest.com

OBJEKTI I AKTIVITETIT

CREDINS INVEST sh.a. ka si objekt të aktivitetit të saj:

Fonde Pensioni: Veprimtarinë e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit vullnetar si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, bazuar në licencën nr. 3, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, datë 23.11.2011.

Fonde Investimi: Veprimtarinë e administrimit të fondeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën me nr. 3, datë 30.05.2016, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Fonde Investimi Alternative: Veprimtarinë e administrimit të fondeve të investimit alternative, mbështetur në licencën me nr. 3, datë 30.05.2016, si dhe Vendimin nr. 207, datë 29.12.2020, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

FONDI I INVESTIMIT CREDINS PREMIUM

FONDET NËN ADMINISTRIMIN E SHOQËRISË CREDINS INVEST SH.A.

Credins Invest sh.a. administron fondet e mëposhtme:

1. Fondi i Pensionit “Credins Pension”

Themeluar me Vendimi nr. 173 i Bordit të AMF, datë 13.11.2011, dhe filloi aktivitetin më 1 Janar 2012. Fondi ka një me horizont investimi afatgjatë, dhe vlera neto e aseteve të fondit më 31 Dhjetor 2020 është: 1,085,034,928 Lekë.

2. Fondi i Investimit “Credins Premium”

Themeluar me Vendimin nr. 86, datë 30.05.2016 nga Bordi i AMF. Fondi është Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, krijuar për një afat të pacaktuar. Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 01.07.2016. Më 31 Dhjetor 2020 vlera neto e aseteve të fondit është: 3,214,518,709 Lekë

3. Fondi i Investimit Alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK

Regjistruar me Vendimin nr. 57, datë 26.03.2021, nga Bordi i AMF. Fondi është një fond investimesh alternative në formën e shoqërisë komandite. Fondi është me afat të papërcaktuar dhe i ofrohet vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar. Asetet e Fondit janë kontribute në natyrë dhe në para. Më 31 Dhjetor 2020 vlera neto e aseteve të fondit është: 2,324,585,000 Lekë.

PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Organet drejtuese te shoqërisë administruese janë: Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli i Administrimit.

Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga aksionarët e shoqërisë si dhe përfaqësuesi ligjor i Bankës Credins sh.a. Aksionarë e shoqërisë janë:

- Banka Credins sh.a. - 76%
- SiCRED sh.a. - 12%
- Znj. Estela Koçi - 5%
- Z. Egi Santo - 3,5 %
- Z. Genc Koxhaj - 3,5%

Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit është organi i vetëm i administrimit, i cili ushtron një kohësisht funksione administrimi e mbikëqyrjeje të veprimtarisë së Shoqërisë (sistemi me një nivel) dhe është i përbërë nga:

1. Znj. Vjosa BODO
2. Z. Eugen NURI, CFA
3. Znj. Estela KOÇI, FCCA
4. Z. Egi SANTO
5. Znj. Armira ÇITOZI

PROSPEKT

Këshilli i Administrimit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, miraton politikat financiare dhe të investimit, emëron dhe shkarkon administratorët apo anëtarët e komitetit të investimit si dhe miraton prospektin e shoqërisë administruese.

Kryerjen e suksesshme të detyrave të mësipërme e mundësojnë eksperiencia dhe kualifikimet e anëtarëve, konkretisht:

- 1) Një titull anëtarësie në Institutin CFA (Chartered Financial Analyst - Analist Financiar i Çertifikuar) që mbulon menaxhimin e portofolit, fushën e analizës financiare dhe investimeve përkatësisht mbajtur nga Z. Eugen NURI, i cili është me eksperiencë të konsiderueshme në fushën e konsulencës financiare.
- 2) Një titull anëtarësie në shoqërinë globale të ekspertëve kontabël të autorizuar ACCA (Association of Certified Chartered Accountants) që mbulon fushën e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, sistemit të kontrolleve të brendshëm, menaxhimit të biznesit, mbajtur nga Znj. Estela KOÇI, e cila ka një eksperiencë të gjatë në fushën e auditimit dhe atë financiare.
- 3) Eksperiencia disa-vjeçare në fushën ligjore e Znj. Vjosa BODO, e cila është zotëruese e titullit JURIST që prej vitit 2001, në respekt të diplomës së lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe është poseduese e titullit AVOKAT dhe anëtare e dhomës së avokatëve të Tiranës që prej vitit 2003. Gëzon eksperiencë disa vjeçare në projektimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe interpretimin e tyre në institucione qendrore shtetërore dhe në shoqëri sigurimi jete me aktivitet në Shqipëri.
- 4) Eksperiencia bankare e z. Egi SANTO, sidomos në drejtim të vlerësimit dhe promovimit të burimeve njerëzore, plotëson më së miri gamën e përvojës dhe kualifikimeve të Këshillit të Administrimit të Credins Invest.
- 5) Eksperiencia mbi 20 vjeçare në fushën e financës e Znj. Armira ÇITOZI, e cila është zotëruese e titullit “Kontabël i Miratuar”, prej vitit 2005. Znj. Çitozi është një ndër personat kyc në procesin e licencimit të Shoqërisë dhe Fondeve.

Administrimi

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Zj. Estela KOÇI.

Zv. Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Znj. Armira ÇITOZI.

Administratori i Përgjithshëm dhe Zv. Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë janë njëkohësisht edhe Anëtarë të Këshillit të Administrimit.

Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë Administruese, i cili kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve, si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në Ligj.

Personeli Kyç

Znj. Eneida Ruçi – Drejtore, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut

Z. Klinti Golemi – Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit të Portofolit

Znj. Rovena Balla – Drejtore, Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit

Znj. Flonilda Sula – Drejtore, Drejtoria Ligjore, Përputhshmërisë dhe PPP

Asnjë nga personat e Personelit Kyç nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria “Credins Invest” ka kryer delegimin e funksioneve në vijim me qëllimin e vetëm të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së shoqërisë dhe cilësisë së kryerjes së këtyre funksioneve. Administrimi me efektivitet i fondit të pensionit vullnetar dhe fondit të investimeve, kryhet nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve dhe investimeve në fondet përkatëse. Nxitja e qendrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit dhe fondit të investimeve ka qenë dhe është një nga objektivat kryesore të shoqërisë. Shoqëria administruese mbetet përgjegjëse për funksionet e deleguara dhe monitorimin/mbarëvajtjen e tyre.

Aktualisht shoqëria administruese ka marrëveshje për delegimin e funksioneve me:

Shoqëria “Banka Credins” sh.a.

1. Funksionin e burimeve njerëzore, i cili konsiston në mbështetjen e shoqërisë administruese nga ana e Credins Bank sh.a., lidhur me zhvillimin e politikave të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të saj. Gjithashtu siguron pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., bazuar në politikat dhe manualët e Credins Bank sh.a. për këtë qëllim.
2. Funksionin e prokurimeve dhe të mirëmbajtjes; Funksioni i prokurimeve konsiston në suportimin e shoqërisë administruese në kontaktet dhe ofertat me të tretët, furnitorë; Funksioni i mirëmbajtjes konsiston në mbështetjen e shoqërisë administruese në lidhje me zgjidhjen e problemeve të ndryshme logjistike të shoqërisë, p.sh. riparime të ndryshme, etj.
3. Funksionin e marketingut, i siguron shoqërisë mbështetjen në fushata të ndryshme publicitare si dhe suportin e kontakteve me të tretët, shoqëri reklamuese, organizuese panairesh, konferencash, evente të ndryshme, etj;
4. Funksionin e teknologjisë së informacionit suporton shoqërinë në lidhje me administrimin e sistemeve të serverave si dhe në ngritjen, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e pajisjeve aktive të rrjetit informativ. Gjithashtu i rekomandon shoqërisë kryerjen sipas rastit të investimeve në networking technologies / solutions të reja për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.
5. Funksionin e sigurisë në mjediset e brendshme të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., për të patur standarde pune të qeta dhe të sigurta;
6. Funksionin e auditimit të brendshëm që bazohet në programin vjetor të punës, i cili është në përputhje me objektivat e kontrollit, dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit. Ky funksion kryhet i plotë, duke shërbyer si një funksion i pavarur nga veprimtaria e përditshme ekonomiko-financiare, për të kontrolluar dhe vlerësuar aktivitetin brenda Shoqërisë “Credins Invest”;
7. Funksionin për Disaster Recovery, i cili konsiston në mundësimin e infrastrukturës në lidhje me ambjentet dhe pajisjet, si dhe kontribuon në planin e rikuperimit të ambjenteve të zyrave dhe pajisjeve.

Për çdo funksion të deleguar informohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

KONFLIKTI I INTERESIT

Shoqëria administruese ka ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të parandaluar konfliktin e interesit që lind në lidhje me veprimtarinë e saj tregtare, si dhe për të identifikuar dhe monitoruar konfliktin e interesit të mundshëm. Kjo, edhe në kuadër të delegimit të disa funksioneve të veprimtarisë së saj në palë të treta.

PROSPEKT

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË FONDIT

KONCEPTE TË PËRGJITHSHME MBI FONDIN

Fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh i krijuar në bazë të një kontrate, dhe i administruar nga një shoqëri administruese e licensuar specifikisht. Fondi grumbullon asete monetare nga investitorët nëpërmjet ofertës së kuotave në fond. Këto asete monetare investohen më pas sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve.

Mbajtësit e kuotave kanë të drejtën, jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por, gjithashtu të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre.

FONDI I INVESTIMIT “CREDINS PREMIUM”


Fondi u themelua me vendimin nr. 86, datë 30.05.2016 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi është sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike, krijuar me pjesëmarrje të hapur dhe në bazë të një kontrate, për një afat të pacaktuar.

Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 01.07.2016.

Fondi Credins Premium ka tregues të riskut sintetik 2, nga shkalla 1 deri në 7 për nivelin e luhatshmërisë. Kuotat në Fond janë të emetuara në monedhën Lekë. Depozitari i Fondit “Credins Premium” është Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

Fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 1.40% gjatë vitit 2020. Vlera neto e aktiveve të fondit në datë 31.12.2020 rezultoi në 3.214.518.709,04 Lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kthimet neto historike të Fondit “Credins Premium”. Norma neto vjetore përfaqëson normën e kthimit të portofolit pasi janë zbritur kostot dhe tarifat që i mbahen fondit. Më 31.12.2020, kohëzgjatja mesatare e modifikuar e portofolit të investimit (Modified Duration) është 3,56 vite. Fondi ka filluar aktivitetin më 1 Korrik 2016 dhe norma e kthimit e paraqitur për vitin 2016 i përket vetëm periudhës 5-mujore 1 Gusht – 31 Dhjetor 2016.



Të dhënat historike mbi kthimit dhe treguesit e rrezikut paraqiten për qëllime ilustrative dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen.

SHUMA MINIMALE E INVESTIMIT

Kuotat në Fond janë të emetuara në lekë.

Shuma minimale e investimit në Fond është 2.000 lekë. Kjo shumë mund të rritet me një vlerë e cila është minimalisht 1.000 lekë. Çdo blerje apo shlyerje kuotash në Fond do të bëhet në lekë. Në rastin kur ligjet dhe rregulloret në zbatim të tyre, aktualisht në fuqi, do të ndryshojnë, Shoqëria Administruese mund të vendosë që blerja dhe shlyerja e kuotave të kryhet në një monedhë tjetër.

DOKUMENTACIONI I FONDIT “CREDINS PREMIUM”

Në zbatim dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullove të publikuara nga AMF, Shoqëria Credins Invest publikon dhe rifreskon në menyrë periodike dokumentacionin e mëposhtëm:

- Prospekti
- Informacionin Kryesor për Investitorin
- Raportet Mujore të Performancës
- Raportet 3-Mujore Financiare
- Pasqyrat Financiare të Audituar

Rregullat e Fondit janë pjesë përbërëse e Aneksit 1 të Prospektit, Kontrata e blerjes së kuotave të fondit. Rregullat i vihen në dispozicion investitorit pa pagesë dhe menjëherë sipas kërkesës së tij.

Prospekti, Raportet vjetore, mujore, dhe çdo informacion shtesë do të vihen në dispozicion të investitorëve pa pagesë pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese. Gjithashtu, dokumentacioni i fondit është i publikuar dhe në faqen zyrtare të Shoqërisë Credins Invest në internet.

INFORMACION PËR INVESTITORËT

Fondi i jep mundësi çdo individ apo institucioni, që ka prioritet sigurinë dhe likuiditetin, të investojë me një profil rreziku të ulët. Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një normë kthimi më të lartë se depozitat bankare, si dhe likuiditetin që i mungon këtyre depozitave, në përputhje me rrezikun që shoqëron asetet ku do të investohet fondi, që do të jenë kryesisht tituj borxhi të emetuar nga Republika e Shqipërisë. Investimi në Fond i jep mundësi investitorëve të diversifikojnë kapitalin e tyre, dhe të përfitojnë nga riinvestimi profesional i fitimeve të gjeneruara.

Për shkak të natyrës së likuiditetit të aseteve ku do të investojë Fondi, (shiko seksionin mbi Politika e Investimit), të cilat shfaqin vështirësi në rast shitje të menjëhershme kur shfaqen kërkesa të shumta për tërheqje (të cilat duhet të kryen brenda 7 ditëve), investitorët në Fond janë të këshilluar që të qëndrojnë të paktën 2 (dy) vjet nga investimi fillestar. Në këtë mënyrë, investitori aktualizon një normë kthimi të kënaqshme.

Investitorët gjithashtu duhet të jenë të ndërgjegjshëm që tërheqjet nga fondi impaktojnë likuiditetin e fondit, sidomos kur janë të paparashikuara dhe në vlera të konsiderueshme. Në këto raste shoqëria detyrohet të bëjë shitje të titujve të portofolit të fondit të cilat mund të shoqërohen me humbje nga cmimi i tregut të transaksionit të shitjes duke impaktuar të gjithë investitorët e tjerë në fond.

Kuotat e këtij Fondi shiten dhe shlyhen në monedhën Lekë. Investitorët duhet të jenë të përgatitur për luhatshmërinë që mund të pësojë çmimi i kuotës gjatë periudhës së investimit si pasojë e ndryshimeve të normave të instrumenteve financiar.

Prospekti, Raportet periodike dhe çdo informacion shtesë, do të vihen në dispozicion të investitorëve pa pagesë, pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese, në adresën Rr. Nikolla Tupe, nr.1, kati III, Tiranë, pas një kërkesë me shkrim, nëpërmjet postës elektronike dhe në adresën zyrtare të internetit të Shoqërisë. Prospekti i Fondit do të jetë i disponueshëm edhe në degët e autorizuara të BANKËS CREDINS, të publikuara në adresën zyrtare të internetit të Shoqërisë. Çdo person i interesuar duhet të verifikojë se ky është varianti i fundit i rishikuar i prospektit.

PROSPEKT

Çdo ndryshim thelbësor i prospektit, bazuar në legjislacionin në fuqi, i njoftohet të gjithë mbajtësve të kuotave nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të shoqërisë administruese, si dhe u dërgohet me postë elektronike brenda gjashtëdhjetë ditëve pune përpara ditës së implementimit të ndryshimeve. Gjatë kësaj periudhe mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë nga Fondi shlyerje të kuotave të tyre.

Të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me çmimin e kuotës dhe vlerën neto të aseteve të kuotë, publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Drejtuesit e lartë të Shoqërisë kanë deklaruar zyrtarisht pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare se interesat e klientëve të Shoqërisë Administruese, nuk do të çënohen nga asnjë konflikt interesi.

Personeli i Shoqërisë Administruese duhet të veprojë gjithmonë me profesionalizëm dhe të vërë në të gjitha njohuritë, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe të pavarur, pa marrë parasysh interesin personal, duke shmangur çdo situatë që është e prirur për të shkaktuar konflikt interesash.

Për çdo ankesë jeni të lutur ta dërgoni me shkrim në adresën zyrtare postare të Shoqërisë Credins Invest sh.a., ose duke plotësuar online në faqen zyrtare të shoqërisë, formën në rubrikën “Sugjerime dhe Ankesa”, në adresën elektronike: ankesa@credinsinvest.com. Ankesat do të shqyrtohen nga strukturat përkatëse, dhe ju do të merrni përgjigje brenda 20 ditëve pune pas pranimit të ankesës.

OBJEKTIVI I INVESTIMIT TË FONDIT

Objektivi i investimit të Fondit është të maksimizojë të ardhurat totale nëpërmjet menaxhimit efektiv të portofolit të aseteve duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. E ardhura totale e ndjekur nga Fondi përbëhet nga të ardhurat nga interesat dhe fitimi / humbja nga rivlerësimi kapitalit. Fondi do të përbëhet vetëm nga tituj borxhi me të ardhura fikse.

Shoqëria Administruese synon të krijojë një portofol të balancuar përse i përket maturitetit të instrumenteve financiare. Qëllimi i Shoqërisë nëpërmjet kësaj strategjie është arritja e objektivave të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit për investitorët, duke minimizuar riskun në raport me kthimin e aseteve përbërëse të portofolit. Për shkak se normat e interesit të obligacioneve dhe bonove ndryshojnë, Shoqëria Administruese nuk garanton një normë të caktuar fitimi gjatë ecurisë së Fondit.

POLITIKA E INVESTIMIT

Fondi do të menaxhohet në mënyrë semi-aktive nga Shoqëria, nëpërmjet përdorimit të analizave statistikore dhe kuantitative duke ndërtuar parashikime të normës së kthimit përkundrejt nivelit të riskut të aseteve përbërëse. Strategjia e përzgjedhjes së aseteve është një proces sistematik dhe dinamik me mekanizma kontrolli dhe balancimi. Asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiare që tregtohen vetëm në Republikën e Shqipërisë, ku do synohet që instrumentet e përzgjedhura do kenë likuiditet sa më të lartë.

Shpërndarja strategjike e aseteve: Shoqëria Administruese do të synojë të respektojë kufijtë e përcaktuar më poshtë për shpërndarjen e aseteve:

FONDI I INVESTIMIT CREDINS PREMIUM

Investimet Kryesore	Pesha (Min-Max)
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	5-20% *
Tituj Borxhi me të ardhura fikse të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë	20-90%
Tituj borxhi të emetuar nga shoqëri tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë dhe organe vendore të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë	0-10%
Kuota të fondeve të investimit me oferte publike të emetuara në Republikën e Shqipërisë	0-10%

*Në çdo rast alokimi i investimeve do të sigurojë respektimin e limiteve të vendosura në rregulloret e miratuara nga AMF, për administrimin e likuiditetit të fondit.

Pesha minimale tregon kufirin e poshtëm ndërsa ajo maksimale tregon kufirin e sipërm të klasës së asetit të specifikuar. Shoqëria synon të investojë brenda këtyre kufijve në asetet përkatëse.

Kufijtë e investimit aplikohen vetëm në momentin e blerjes së asetit. Çdo ndryshim tjetër si rezultat i luhatjeve të vlerës së tregut, apo i karakteristikave të aseteve të fondit (ndryshime në “rating”, apo ndryshim në kohëzgjatjen e portofolit), nuk do të kërkojë shitjen e aseteve, përveç rasteve kur Komiteti i Investimeve e gjykon të arsyeshme shitjen e asetit. Fondi mund të vazhdojë të mbajë këto asete nëse Komiteti i Investimit e vlerëson këtë veprim në të mirë të anëtarëve të Fondit. Shoqëria mund të zbatojë dhe strategji më fleksibël të alokimit për periudha të caktuara në varësi të luhatshmerisë në tregun financiar dhe flukseve hyrëse-dalëse në Fond. Gjithashtu, Shoqëria ka fleksibilitet për të bërë ndërhyrje afatshkurtra në alokim për të përfituar nga mundësi që ofron tregu nëse kjo do jetë në përfitimin e investitorëve të Fondit, dhe në përputhje me objektivat e Fondit.

Për të arritur objektivin e investimit, Fondi do të investojë më shumë se 35% të vlerës së aseteve në tituj të transferueshëm të lëshuara ose të garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë që një pjesë e aseteve mund të investohen në tituj borxhi të emetuar nga shoqëri tregtare dhe organe vendore, të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë dhe në kuota të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur që funksionojnë në Republikën e Shqipërisë.

Në kushtet e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, maksimizimi i fitimit arrihet duke investuar të paktën 50-90% të aseteve në obligacione afatgjatë, dhe duke shfrytëzuar fitimin nga rivlerësimi i kapitalit. Shoqëria do të konkurrojë në mënyrë aktive në ankandet e bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë dhe do të marrë pjesë në tregun sekondar kur kushtet favorizojnë shit-blerjen e një titulli apo për qëllime likuiditeti. E ardhura nga interesi zë pjesën më të madhe të së ardhurës totale duke konsideruar luhatshmërinë e vogël të vlerës së tregut të obligacioneve qeveritare. Kjo sjell një normë kthimi stabël.

Për të arritur diversifikimin, Fondi mund të investojë shuma të moderuara sipas limiteve të përmendura më lart dhe në tituj borxhi korporativ, të emetuara nga shoqëri tregtare me reputacion që kanë një vlerësim të përshtatshëm të kreditimit. Investime mund të kryhen edhe në tituj korporativ të pavlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare, por janë të tregtueshëm në tregje të rregulluara dhe në përputhje me politikat e rrezikut të Fondit.

Për identifikimin e investimeve në tituj korporativ do kryen analiza makroekonomike, të sektorëve industrial ku operojnë korporatat e përzgjedhura dhe të elementëve thelbësorë të të dhënave financiare, sipas një metodologjie të përcaktuar.

PROSPEKT

Me qëllim të diversifikimit të portofolit, Fondi mund të investojë deri në 10% të aseteve në kuota të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, të cilat janë të licencuara nga AMF për të ushtruar aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 56/2020 datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Përzgjedhja e këtyre instrumenteve do të bëhet mbi bazë të kriterëve të likuiditetit, kthimit dhe riskut që mbartin. Investimet do të bëhen në kuota të fondeve, portofolet e aseteve të cilave kanë risk dhe luhatshmëri të ngjashme me indikatorët e Fondit.

Me qëllim administrimin e likuiditetit afatshkurtër dhe plotësimin ligjor të çdo detyrimi ndaj klientit, si dhe të kërkesave të specifikuar nga AMF në lidhje me likuiditetin, një pjesë e aseteve të Fondit do të mbahen në formën e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre duke u investuar në instrumenta me likuiditet të lartë si:

- Depozita në Lekë me maturim jo më shumë se 1 vit;
- Marrëveshje të riblerjes dhe e anasjellta riblerjes në institucione të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

Fondi do të nënshkruajë kontrata derivative vetëm për qëllime të mbrojtjes nga risqet ndaj të cilave ai ekspozohet, duke mbajtur në konsideratë kufijtë e lejuar nga baza ligjore në fuqi.

Ndryshimet në politikën e investimit aprovohen më parë nga organet drejtuese të Shoqërisë dhe AMF. Në rastin e një ndryshimi, koha e përshtatshme do t'i jepet anëtarëve të fondit për të marrë vendimet e tyre në lidhje me largimin apo qëndrimin në fond. Politika dhe objektivat e investimit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin e AMF.

DURATION (KOHËZGJATJA)

Kohëzgjatja është matësi i rrezikut nga normat e interesit të një letre me vlerë me të ardhura fikse (obligacion) që tregon sensitivitetin e çmimit të një letre me vlerë nga ndryshimet e normave të interesit. Sa më e madhe të jetë kohëzgjatja, aq më i madh do të jetë sensitiviteti dhe për rrjedhojë ndryshimi i vlerës së tregut të letrës me vlerë nga ndryshimi i normave të interesit. Një fond me një kohëzgjatje mesatare më të lartë do të jetë më sensitiv në krahasim me një fond me një kohëzgjatje më të vogël.

Kohëzgjatja mesatare e portofoli i investimit të fondit “Credins Premium” do të jetë më e vogël ose e barabartë me 5 (pesë) vjet.

FAKTORËT E RREZIKUT

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Investimi në Fond detyrimisht përfshin sipërmarrjen e rrezikut nga investitori. Sa më e lartë të jetë norma e kërkuar e kthimit, aq më i lartë është rreziku i ndërmarrë, dhe sa më e vogël të jetë toleranca për rrezik e investitorëve, aq më e vogël do të rezultojë norma e kthimit.

Siç përcaktohet në seksionin e politikës së investimeve, objektivat në përzgjedhjen e instrumenteve financiare të Fondit janë siguria, likuiditeti dhe përfitimi.

Çmimi i aseteve financiare në Fond mund të rritet ose të bjerë krahasuar me çmimin e blerjes së kuotave. Në rast se investitori i shet kuotat e Fondit në një moment që çmimet e aseteve të Fondit kanë rënë në krahasim me çmimin e blerjes së kuotës, kjo nënkupton që investitori nuk do të mund të recuperojë të gjithë shumën e investuar në Fond. Risku i investitorit është i kufizuar deri në shumën e kapitalit të investuar në Fond.

FONDI I INVESTIMIT CREDINS PREMIUM

Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi të emetuar nga Republika e Shqipërisë. Pavarësisht faktit që këto tituj kanë një rrezik më të ulët, krahasuar me titujt e borxhit të emetuar nga shoqëritë tregtare dhe organet vendore, investitori është i ekspozuar nga rreziku i garancisë dhe i besueshmërisë së Shtetit Shqiptar dhe i ndryshueshmërisë së normave të interesit që ato japin. Gjithashtu, këto tituj borxhi tregtohen në një treg me aktivitet të pakët, gjë që e vështirëson shitjen e këtyre titujve nëse lind nevoja për likuiditet të menjëhershëm si pasojë e tërheqjeve të parakohshme apo të pa-planifikuara të klientëve.

Risku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht, por risku mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e përshtatshme për administrimin e tij. Për këtë qëllim, Shoqëria administruese ka krijuar një sistem të administrimit të rreziqeve i cili i siguron identifikimin, monitorimin, matjen dhe raportimin në çdo kohë të rreziqeve ndaj të cilave është i ekspozuar Fondi dhe Shoqëria.

Njësia e Administrimit të Riskut vepron e pavarur nga njësitë e tjera të Shoqërisë dhe është përgjegjëse për administrimin e riskut brenda Shoqërisë. Menaxheri i Riskut kryen identifikimin, matjen dhe kontrollin si sasi dhe cilësor të risqeve dhe bën menaxhimin dhe raportimin e tyre. Ai kontrollon aktivitetin e Menaxherit të Portofolit në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet në përputhje me riskun ekzistues të portofolit dhe jep rekomandime për mbajtjen e niveleve të përshtatshme të riskut brenda kufijve të përcaktuar. Menaxheri i Riskut kryen provat e rezistencës në kushte normale dhe në kushte të stresuara të tregut me qëllim monitorimin e ecurisë së fondit dhe treguesit të likuiditetit.

Politika e menaxhimit të Riskut udhëhiqet nga natyra e Fondit si edhe tolerancës për risk e përcaktuar në objektivat e investimit të Fondit. Metodologjitë e vlerësimit të riskut mbështeten në praktikën më të mirë, si edhe ligjet e rregulloret në fuqi.

Krahas saj, Shoqëria ka promovuar një kulturë të njohjes dhe të administrimit të riskut nga çdo punonjës i Shoqërisë. Punonjësit e çdo njësie njihen me risqet ndaj të cilave ekspozohet Fondi dhe Shoqëria dhe sigurohen që çdo risk që bie mbi njësitë e tyre operacionale, administrohet sipas politikave dhe procedurave të miratuara.

Në vijim janë evidentuar risqet potenciale ndaj të cilave investitori mund të ekspozohet, përmes investimeve të fondit, ose përmes shoqërisë administruese.

KARAKTERISIKAT E RREZIKUT TË ASETVE NË FOND

Depozitat në institucionet e kreditimit

Depozita si klasë asetit zotëron rrezikun e kredisë së institucionit financiar dhe rrezikun e ri-çmimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i ri-çmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot e Republikës së Shqipërisë

Këto asete dhe pagesat e interesit dhe principalit, që paguajnë ato, mbështeten mbi besimin e plotë në sovranitetin dhe aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Notat e kreditit shërbejnë për të vlerësuar këtë rrezik kredie. Obligacionet apo Bonot qeveritare konsiderohen me rrezikun më të ulët të kreditit në treg. Obligacionet dhe bonot janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit. Bonot përmbajnë rrezik më të lartë nga interesat krahasuar me obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim. Obligacionet e Republikës së Shqipërisë mbartin rrezikun e likuiditetit për shkak të tregut jo-aktiv të këtyre instrumenteve, gjë e cila vështirëson shitjen e tyre nëse lind nevoja. Gjithashtu këto tituj borxhi mbartin rrezikun politik në rast se si pasojë e ndryshimeve politike përkeqësohen treguesit e borxhit.

PROSPEKT

Obligacionet dhe Bonot Korporative

Obligacionet dhe bonot korporative përmbajnë rrezikun e kredisë që mbart kompania që emeton. Këto tituj borxhi, dhe vlerësohen si me rrezik më të lartë kredie se titujt e borxhi të emetuar nga Republika e Shqipërisë. Këto tituj borxhi zotërojnë rrezikun nga normat e interesit, të cilat përcaktojnë vlerën e tij në treg dhe mbartin një rrezik të lartë likuiditeti. Këto asete përfaqësojnë një pjesë të vogël të portofolit të Fondit. Ky lloj investimi do të bëhet vetëm për të arritur diversifikimin e portofolit.

Obligacionet dhe Bonot e Organeve Vendore të Republikës së Shqipërisë

Kjo klasë aseti mbart rrezikun e kredisë të institucioneve vendore (bashkitë) që emetojnë këto tituj borxhi. Rreziku i kreditit i organeve vendore varet nga besueshmëria dhe aftësia paguese, që rrjedh nga vjelja e taksave vendore. Këto tituj borxhi mbartin rrezik të lartë likuiditeti dhe nga normat e interesit.

Kuota të fondeve të investimeve të liçensuar nga AMF

Investimi në këtë instrument financiar do të përbëjë jo më shumë se 10% të aseteve të fondit dhe do të përdoren kryesisht për diversifikim të portofolit. Investimi në këto asete mbart rrezikun e aseteve të mbajtura nga këto fonde dhe strategjisë së tyre të investimit. Investimi në kuota do të kryhet me kushtin që portofolet e këtyre fondeve të kenë karakteristika të ngjashme të luhatshmërisë dhe riskut sintetik me Fondin Premium. Gjithashtu investimet e tyre në kuota të fondeve të tjera të investimit nuk duhet të jenë më shumë se 10% e vlerës së aktiveve të tyre në një fond të vetëm.

Rating-u i Kreditit dhe Instrumentat që nuk kanë “Rating”

Agjensitë e huaja të “rating-ut” ofrojnë shërbimin e vlerësimit të aftësisë paguese të emetuesve të ndryshëm të instrumentave me të ardhura fikse (obligacione). Vlerësimet (“rating”) e vendosura nga këto kompani nuk përbëjnë vlerësimin absolut të aftësive paguese dhe nuk vlerësojnë rrezikun e tregut. Agjencitë mund të mos përditësojnë në kohë ndryshimin e një apo disa notave si pasojë e ndryshimeve të gjendjes financiare të emetuesve. Fondi nuk do të shesë një instrument në momentin e uljes së notës së kreditit nga agjencitë e rating-ut. Menaxheri i Portofolit nuk merr vendime vetëm duke u bazuar në notat e kreditit të vendosura nga agjensitë e rating-ut. Ai zhvillon analizën e tij personale në lidhje me aftësitë paguese të emetuesit. Më pas, Komiteti i Investimeve vendos se cili vlerësim reflekton më mirë aftësinë paguese të emetuesit.

Fondi mund të blejë një instrument që nuk ka notë vlerësimi nga agjencitë e vlerësimit nëse Komiteti i Investimeve vlerëson se instrumenti në fjalë i korrespondon një note që do të pranohej si blerje potenciale në fond. Instrumentat që nuk kanë nota vlerësimi zotërojnë likuiditet të pakët dhe janë subjekt i rrezikut që Komiteti i Investimeve mund të mos arrijë në një përcaktim të saktë të aftësisë paguese të emetuesit.

RREZIQE TË LIDHURA ME INVESTIMIN

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është risku i humbjes nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të Fondit që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave apo klasifikimi i rrezikut të kreditit të emetuesit. Çmimet e instrumenteve financiare varen kryesisht nga zhvillimet në tregjet e kapitalit të cilat nga ana tjetër ndikohen nga situata e përgjithshme ekonomike dhe politike e shteteve. Një formë e rrezikut të tregut është rreziku nga normat e interesit.



Rreziku nga normat e interesit

Rreziku nga normat e interesit shpreh mundësinë që niveli i përgjithshëm i normave të interesit në treg mund të ndryshojë krahasuar me kohën kur është emetuar instrumenti financiar. Ndryshimet në nivelin e normave të interesit mund të vijnë si rezultat i ndryshimeve në faktorët ekonomikë dhe politikë të një vendi dhe veprimeve të ndërmarra nga Banka Qendrore krahas faktorëve të tjerë. Rritja e normave të interesit sjell zvogëlim të vlerës së tregut të instrumentave me të ardhura fikse (obligacionet, bonot).

Asetet me kohëzgjatje më të madhe janë shumë më sensitive se asetet me kohëzgjatje më të ulët. Për rrjedhojë, vlera e tyre pëson luhatje më të mëdha. Fondi ka vendosur kufij të brendshëm në lidhje me kohëzgjatjen e aseteve me të ardhura fikse, në mënyrë që të monitorojë dhe të mbajë brenda kufijve strukturën e portofolit të titujve në bazë të shpërndarjes strategjike të aseteve.

Rreziku i kursit të këmbimit

Një formë tjetër e rrezikut të tregut është rreziku i kursit të këmbimit, i cili shpreh mundësinë që zhvlerësimi i monedhës të ndikojë negativisht vlerën e aseteve të fondit ku këto asete janë të investuara në monedha të ndryshme nga monedha e fondit. Fondi në përputhje me politikën e investime të tij, do të investojë vetëm në monedhën Lekë, dhe si rezultat nuk do jetë i ekspozuar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Rreziku i Kredisë

Krahas ecurisë së tregjeve të kapitalit, situata dhe ecuria e një emetuesi gjithashtu ka një ndikim në çmimin e instrumenteve. Konkretisht, rreziku i kredisë është mundësia e humbjes së Fondit në rast se një emetues i aseteve të Fondit është në pamundësi të plotë ose të pjesshme të shlyejë detyrimet e tij të lidhura me asetet e Fondit, duke ndikuar negativisht asetet e Fondit. Përzgjedhja me kujdes e investimeve nuk e eviton mundësinë e humbjes kur emetuesi është në paaftësi paguese apo ka pasur humbje në aktivitetet e tij operacionale.

Obligacionet dhe bonot përmbajnë një spektër gradash të rrezikut të kredisë, i cili reflektohet në “rating” (notat e kreditit) e tyre. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi të Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë është lidhur ngushtë me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përbën pamundësinë për të likuiduar një aset në kohë apo për ta likuiduar atë me një normë kthimi pa humbje. Në disa raste tregu për një instrument të caktuar mund të boshatiset ose të tregtohet në segmente shumë të ngushtë tregu duke e bërë të pamundur tregtimin e tij ose që çmimi i tij të jetë shumë i luhatshëm.

Gjithashtu shitja e sforcuar e një aseti për të përmbushur kërkesat për likuiditet mund të rezultojë me një normë kthimi më të vogël se çmimi që ka në portofolin e Fondit duke sjellë një humbje për Fondin. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi të Qeverisë së Shqipërisë. Tregu sekondar i këtyre titujve konsiderohet treg jo-aktiv me aktivitet të kufizuar.

Për këtë arsye, rregullat e menaxhimit të likuiditetit të Fondit do të jenë në përputhje me Rregulloren për administrimin e likuiditetit për fondet e investimeve, miratuar nga AMF.

Rreziku i shlyerjes

Rreziku i shlyerjes lind kur një transaksion nuk mund të shlyhet ose të shlyhet me vonesë në një sistem transfertash, për arsye se pala tjetër dështon të paguajë brenda afatit të pritur.

Rreziku i palës tjetër

Rreziku i palës tjetër lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshje të paracaktuar, pas kryerjes së një transaksioni.

PROSPEKT

Rreziku i përqëndrimit

Rreziku i përqëndrimit është rreziku i humbjes nga përqëndrimi i aktiveve të Fondit në një emetues në kategori ose tregje të caktuara (sektorë apo zona gjeografike të caktuar). Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi të emetuar nga Republika e Shqipërisë, dhe për rrjedhojë portofoli nuk është i mirëdiversifikuar. Stabiliteti ekonomik dhe politik apo çdo problematikë e fokusuar vetëm te Shteti Shqiptar, e bën të pambrojtur performancën e fondit.

Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha mund të ketë impakt negativ në performancën e Fondit, sepse amplifikon humbjet që mund të vijnë nga shitja e pafavorshme e një instrumenti financiar, me pasojë rënie të çmimit të kuotës.

Rreziku i vlerësimit të aseteve

Për shkak të tregjeve jo-likuide Fondi vlerëson asetet e tij sipas modelit ‘mark-to-model’, që nënkupton përdorimin e disa supozimeve për llogaritjen e vlerës së drejtë të aseteve në bazë të metodologjisë përkatëse të miratuar. Në rastet kur investitorët mund të kërkojnë të tërheqin kuotat e tyre në të njëjtën kohë, Fondi mund të jetë i detyruar të shesë tituj borxhi nga portofoli i Fondit, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre, duke pasur një ndikim negativ në performancën e fondit.

Rreziku i inflacionit

Rreziku i inflacionit përbën rrezikun që ndryshimet në indeksin e çmimeve në ekonomi mund të japin një ulje të kthimeve nga investimi si rezultat i rënies së fuqisë blerëse të parave të investuara. Niveli i inflacionit në vend gjithashtu mund të ndikojë (negativisht) në çmimin e aseteve të Fondit.

Rreziku i agjencisë

Rreziku i Agjencisë është dëmi që mund t’i shkaktohet fondit nga vendimmarrje të qëllimshme të administratorëve të Shoqërisë apo menaxherët e fondit, për interesa personale dhe në kundërshtim me interesat e investitorëve të fondit. Për parandalimin e këtyre veprimeve, Shoqëria administruese ka hartuar politika e procedura të brendshme dhe ka krijuar mekanizmat e nevojshëm të kontrollit.

Rreziku i depozitarit

Funksioni i depozitarit kryhet nga një subjekt i licencuar nga AMF siç shpjegohet në seksionin “DEPOZITARI”. Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore, dhe në këtë rast disa aktivitete të fondit, si për shembull regjistrimi i aseteve të Fondit apo përlllogaritja e vlerës neto të aseteve, mund të vonohen.

Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerjen e kuotave të Fondit. Megjithatë, shoqëria administruese apo AMF mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara sipas ligjit siç shpjegohen në në paragrafin “PEZULLIMI I SHLYERJES SË KUOTAVE TË FONDIT” të këtij prospekti.



Rreziku politik

Rreziku politik lidhet me ndryshimin në mjedisin politik, i cili mund të ketë impakt negativ në të gjithë bizneset dhe ekonomine e vendit. Njëkohësisht vlerësimet për një mungesë stabiliteti politik në vend, edhe sipas vlerësimeve të jashtme të agjencive të kreditimit, mund të ndikojnë në rritjen e kostove të borxhit dhe rritje të normave të interesit në treg të cilat ndikojnë në çmimin e aseteve të Fondit.

RREZIQE TË TJERA

Krahas rreziqeve të mësipërme të lidhura me Investimin, Shoqëria administruese mund të përballë edhe me rreziqe të tjera të biznesit të cilat mund të sjellin humbje për shoqërinë apo dëmtojnë reputacionin e saj, si rreziku operacional, ligjor, reputacional, rregullator, rreziku i personelit kyç dhe rreziku i delegimit të funksioneve.

Rreziku operacional

Rreziku operacional përbën rrezikun e humbjeve nga mosfunksionimi i sistemeve të Fondit, nga gabime operacionale të punonjësve të Shoqërisë, nga procedura të brendshme të papërshtatshme, ose nga faktorë të jashtëm dhe që përfshin risqe ligjore, të dokumentacionit, të procedurave të marketingut, shlyerjes dhe vlerësimit që zbatohen nga Fondi. Shoqëria përpilon procedurë të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e rrezikut operacional.

Rreziku ligjor

Rreziku ligjor përbën rrezikun e humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e shoqërisë administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

Rreziku reputacional

Rreziku reputacional konsiston në perceptimin e publikut në lidhje me besueshmërinë e shoqërisë administruese duke përfshirë impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht perceptimin e publikut për shoqërinë.

Humbja e reputacionit mund të sjellë humbje në të ardhura dhe ulje të vlerës së aksionerëve.

Rreziku rregullator

Rreziku rregullator nënkupton paqartësinë dhe pasigurinë që shoqërojnë ndryshimet e kuadrit rregullator të vendit, të cilat mund të ndikojnë mbi performancën e fondit.

Rreziku i personave dhe personelit kyç

Performanca e Fondit i detyrohet profesionalizmit dhe aftësive të personelit drejtues, Këshillit të Administrimit dhe Komitetit të Investimit, të cilët mund të ndryshojnë dhe për rrjedhojë kjo mund të ndikojë dhe në performancën e ardhshme të Fondit.

Rreziku nga delegimi i disa funksioneve

Disa funksione në administrimin e Fondit, i delegohen palëve të treta të cilat mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Kjo mund të ekspozojë Shoqërinë administruese pasi ajo mban përgjegjësinë finale ligjore për funksionet e deleguara.

PROSPEKT

PARIMET PËR EKZEKUTIMIN MË TË MIRË TË MUNDSHËM

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Shoqëria administruese do të veprojë në interesin më të mirë të klientëve të Fondit kur ekzekuton vendime tregtimi për administrimin e Fondit. Në këtë kuadër, Shoqëria do të ndërmarrë çdo veprim nën autoritetin e saj për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për Fondin.

Parimet kryesore që zbatohen nga Shoqëria administruese për ekzekutimin optimal të vendimeve të tregtimit, për blerjen dhe shitjen e asetëve si pjesë e administrimit të Fondit, janë:

KRITERET E EKZEKUTIMIT

Kriteret e mëposhtme janë relevante për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme për asetet e Fondit:

- Çmimi/norma e interesit;
- Kostot/komisionet;
- Probabiliteti i ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes;
- Shpejtësia e ekzekutimit;
- Tipi dhe qëllimi i urdhërit;

Rezultati më i mirë i mundshëm nuk përcaktohet vetëm nga çmimi. Rëndësia relative e kriterëve të specifikuar përcaktohet, por nuk kufizohet, nga faktorët e mëposhtëm:

- Objektivat e investimit, politika e investimit, dhe rreziqet e Fondit;
- Karakteristikat e urdhrit të dhënë;
- Karakteristikat e instrumenteve financiare që janë subjekt i këtij urdhri;
- Karakteristikat e vendit të ekzekutimit të urdhrit;

Në varësi të tipit dhe karakteristikave të transaksionit, faktorë të tjerë si kriteri i kohës së ekzekutimit, volumi i tregtimit dhe ngjarje të tjera të paparashikuara mund të ndikojnë në vendimmarrje.

Shoqëria administruese pas përfundimit të çdo transaksioni kontrollon nëse transaksioni është kryer në përputhje me të dhënat e tregut.

Shoqëria administruese duhet të sigurojë që urdhër tregtimi është ekzekutuar në mënyrën më të mirë të mundshme si edhe vendimet e tregtimit janë kryer duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët relevantë duke përfshirë konfliktet e mundshme të interesit, edhe të veprojë në interesin më të mirë të mundshëm të asetëve të Fondit.

PËRZGJEDHJA E PARTNERËVE (NDËRMJETËSVE) TË TREGTIMIT

Shoqëria administruese sigurohet që përzgjedhja e partnerëve për ekzekutimin e urdhrave të tregtimit të kryhet mbështetur në kriteret të mirëpërcaktuara në politikën e brendshme të Shoqërisë për ekzekutimin e urdhrave të tregtimit.

PËRZGJEDHJA E VENDEVE TË TREGTIMIT

Veprimet e tregtimit mund të ekzekutohen në tregje të rregulluara vendase, në platforma shumëpalëshe tregtimi (PSHT) ose përmes tregut mbi banak (OTC).

“Treg i rregulluar” është sistemi shumëpalësh që shfrytëzohet dhe/ose administrohet nga një subjekt operator tregu, i licencuar nga autoriteti përkatës, i cili mundëson shitblerjen e instrumenteve financiarë, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij. Instrumentet financiare pranohen për tregtim sipas rregulloreve dhe/ose sistemeve të tregut të rregulluar dhe



ai licencohet, regjistrohet ose njihet nga autoriteti.

Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emetuar dhe garantuar nga Qeveria Qendrore e Republikës së Shqipërisë, me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

Sipas llojit të tregtimit, kriteret të cilat merren në konsideratë kur ekzekutohen vendimet e tregtimit janë:

Transaksionet me bonot dhe obligacionet zakonisht kryhen përmes platformave të tregtimit ose direkt me kundërpalët. Për këto tregtime, çmimi/norma e interesit, volumi, shpejtësia në ekzekutimin e transaksionit dhe kriteret e tjera bllokuese janë përcaktuese të vendimit të tregtimit. Në raste të emetimit për herë të parë të obligacioneve në tregun primar, merret në konsideratë dhe probabiliteti i shpalljes fitues (“probability of allocation”) krahas kriterëve të tjera të lart përmendura. Kur përzgjedhen kundërpalët në tregtim, vlerësohen kriteret si besueshmëria e kuotimit të çmimit, shpejtësia e ekzekutimit, veprimet pas-ekzekutimi si edhe reputacioni në treg. **Për titujt e pjesëmarrjes në kapital, fondet, fondet e investimit të tregtuara në bursë, dhe notat e kreditit dhe obligacionet e tregtuara në bursë**, likuiditeti është një faktor primar që merret në konsideratë në vendimin e tregtimit.

Kur likuiditeti është i lartë, kriteri i çmimit/normës së interesit dhe shpejtësia e ekzekutimit ponderohen me peshë më të lartë në vendimarrje, ndërsa në rastet kur likuiditeti është i ulët në treg kriteri i tipit dhe qëllimit të tregtimit dhe mundësia e ekzekutimit dhe shlyerjes ponderohen me peshë specifike më të lartë.

KONFLIKTI I INTERESIT

Shoqëria ka përfshirë në rregulloret e saj të brendshme si dhe në kodin e etikës kriteret sipas Ligjit nr. 56/2020 dhe rregullores nr.2 datë 27.01.2021, për identifikimin dhe shmangien e konfliktit të interesit për ekzekutimin më të mirë të investimeve për Fondin. Personeli kyç që është pjesë e Komitetit të Investimeve nuk do jetë i përfshirë në aktivitete të tjera personale të cilat mund të përbëjnë shkak për ndikim në marrjen e vendimeve për investime dhe ekzekutimin e tyre në mënyrë të përshtatshme.

RISHIKIMI I PARAMETRAVE THEMELORE

Tregjet e përzgjedhura sipas këtyre kriterëve do të rishikohen nga Shoqëria Administruese çdo vit dhe do të kryhen ndryshimet e nevojshme. Rishikimi mund të kryhet edhe kur Shoqëria beson që kriteret të rëndësishme të cilat zbatoheshin për një treg të caktuar, nuk janë më relevante për zbatim.

TË DHËNA TË TREGJEVE TË RREGULLUARA

Në Republikën e Shqipërisë janë aktualisht 3 tregje të rregulluara, ku fondi operon dhe kryen aktivitet të blerjes dhe shitjes së instrumenteve.

Tregu primar i titujve shtetëror

Titujt shtetërorë apo letrat me vlerë të qeverisë, janë instrumente borxhi të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Titujt shtetërorë emetohen në formën e bonove të thesarit dhe obligacioneve, në monedhë kombëtare dhe të huaj. Bonot e thesarit janë instrumente financiare afatshkurtër me maturim 3, 6 dhe 12 mujor. Obligacionet e thesarit janë instrumente financiare afatmesëm dhe afatgjatë me maturitet 2, 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare.

Volumet vjetore të emetimit të titujve shtetëror janë të ndryshueshëm në varësi të nevojave të shtetit shqiptar për borxh të brendshëm dhe publikohen në kalendar emetimi çdo 3 muaj.

PROSPEKT

Bursa Shqiptare e Titujve

Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE) është bursë titujsh me kapital privat që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë. Në Bursën ALSE tregtohen të gjithë llojet e instrumenteve financiare që njihen nga Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” (i ndryshuar), dhe që plotësojnë kriteret e listimit apo kuotimit të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ALSE. ALSE mundëson krijimin e një tregu sekondar të rregulluar ku listohen tituj të shtetit shqiptar, të emetuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në tregun primar të organizuar nga Banka e Shqipërisë.

Që prej muajit shkurt të vitit 2019, në Bursën ALSE lejohet të listohen edhe tituj të tjerë përveç titujve të borxhit të Qeverisë, duke i hapur në këtë mënyrë rrugën e listimit të titujve të emetuar nga korporata shqiptare.

“Tregtimi mbi banak”

Sipas perkufizimit të Ligjit Nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, tregjet mbi banak të titujve që janë emetuar dhe garantuar nga Qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë, janë tregje të rregulluara me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

ADMINISTRIMI I FONDEVE

PËRLLOGARITJET DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË ASETVE, VLERËS NETO TË ASETVE DHE ÇMIMIT

Shoqëria administruese duhet të përcaktojë vlerën e asetve të fondit të investimeve dhe të të gjitha detyrimeve e tarifave të saj, para se të llogarisë vlerën neto të asetve për çdo kuotë apo çmimin për çdo kuotë. Metoda e vlerësimit të asetve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit Nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Rregullores nr. 2, datë 27.01.2021 “Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët” dhe parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Një aset i Fondit vlerësohet në mënyrë periodike nga Shoqëria nëse tregtohet në një treg aktiv apo treg joaktiv sipas përcaktimeve të nenit 26 dhe 27 të Rregullores nr.2 datë 27.01.2021. Shoqëria dhe Depozitari krijojnë dhe dokumentojnë një procedurë për vërtetimin e gjyqimit të tyre për klasifikimin e një instrumenti financiar nëse tregtohet në një treg aktiv apo joaktiv.

Asetet që tregtohen në Treg Aktiv

Asetet e Fondit të cilat janë të listuara dhe tregtohen në një treg aktiv do të vlerësohen me vlerën e drejtë. Çmimi i tregut në një treg aktiv garanton dëshminë më të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret pa përshtatje për të matur vlerën e drejtë. Rrjedhimisht, asetet e fondit që klasifikohen nga Shoqëria si të tregtuara në një treg aktiv do të vlerësohen me çmimin e fundit në dispozicion të tregut në momentin e vlerësimit.

Për asetet të cilat nuk tregtohen në treg aktiv por që janë identike me asetet që kuotohen në treg aktiv do të përdoren çmimet e fundit të asetve të kuotuar në treg aktiv në momentin e vlerësimit.



Asetet që tregtohen në Treg Joaktiv

Në rastin kur tregu është joaktiv, vlerësimi i instrumentit do të bëhet nga metodologjia e hartuar nga Shoqëria dhe e konsultuar me Depozitarit duke marrë gjithashtu në konsideratë opinionin e Audituesit të jashtëm të Shoqërisë.

Shoqëria dhe Depozitari dokumentojnë metodologjinë e hartuar për vlerësimin e instrumenteve që tregtohen në një treg joaktiv.

Vlera neto e aseteve dhe çmimi

Për të përcaktuar vlerën e pjesëmarrjes në sipërmarrjen e investimeve kolektive ose në nënfond, shoqëria administruese e fondeve kryen një vlerësim të rregullt dhe të saktë të të gjitha aktiveve që i përkasin fondit.

Vlera neto e aseteve është vlera e totalit të aseteve të fondit, pra investimet afatgjata, të shtuara me asetet afatshkurtra, minus të gjitha detyrimet e tij. Vlera neto për kuotë është vlera neto e aseteve të fondit, e pjesëtuar me numrin e kuotave të fondit në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit. Vlera neto e aseteve të një fondi investimi llogaritet çdo ditë dhe publikohet në faqen zyrtare www.credinsinvest.com.

Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet konform dispozitave të Ligjit për SIK dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Shoqëria dhe Depozitari kanë rënë dakord për të aplikuar metodologjinë për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit për çdo klasë aktivi dhe çmimit të kuotës.

Mjetet monetare dhe ekuivalente: Për vlerësimin e depozitave dhe marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (“reverse repo”), përdoret metoda e kostos së amortizuar, përkatësisht vlera nominale e rritur me interesin e akumuluar. Të ardhurat nga interesat nga depozitat llogariten në bazë ditore dhe pagesa kryhet në datën e maturimit. Baza për përlllogaritje është 365 ditë dhe interesi fillon në ditën e parë.

Tituj borxhi qeveritare: Në rastin e titujve të borxhit qeveritar, të tregtuar në treg joaktiv, rivlerësimi kryhet në bazë të një metodologjie që mbështetet në yield-in në maturim. Përlllogaritjet për titujt kryhen me metodën e interpolimit linear, sipas yield-eve më të fundit të ankandeve të bonove dhe obligacioneve qeveritare dhe ditëve të mbetura deri në maturim të titujve.

Tituj Koorporativ: Titujt Koorporativ të kuotuar zyrtarisht në treg aktiv vlerësohen duke përdorur çmimin e fundit “Bid” të publikuar në dispozicion.

Tituj Koorporativ të treguar në një treg të rregulluar joaktiv vlerësohen në bazë të metodologjisë që mbështetet në yield-in në maturim. Përlllogaritjet për titujt kryhen me metodën e interpolimit linear sipas yield-eve më të fundit të titujve qeveritar të tregtuara dhe ditëve të mbetura deri në maturim, duke i shtuar një prim për rrezikun e kreditit të emetuesit, i përcaktuar sipas metodologjisë së rënë dakord me depozitarin.

Tituj të organeve vendore: Në rastin e titujve të borxhit të organeve vendore, rivlerësimi kryhet në bazë të një metodologjie që mbështetet në yield-in në maturim. Përlllogaritjet për titujt kryhen me metodën e interpolimit linear sipas yield-eve më të fundit të titujve të tregtuara dhe ditëve

PROSPEKT

të mbetura deri në maturim të titujve. Metodologjia dakordësohet paraprakisht me depozitarin. Në këtë rast yield-it i shtohet një prim për rrezikun e kreditit të emetuesit, i përcaktuar sipas metodologjisë së rënë dakord me depozitarin.

Kuota të Fondeve: Vlerësimi i investimeve në kuota të fondeve të investimit bëhet në bazë të çmimit më të fundit zyrtar të kuotës të publikuar në momentin e vlerësimit.

Derivatvët: vlerësohen në bazë ditore sipas çmimit më të fundit të ofertës të tregtimit në tregjet e rregulluara.

Çmimi i kuotës në një fond investimi llogaritet çdo ditë duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të fondit deri në orën 17:00 të asaj dite, me numrin e kuotave të emetuara. Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes.

Shoqëria Administruese publikon në ditën tjetër të punës në faqen zyrtare www.credinsinvest.com. informacionin për vlerën e aseteve të fondit të investimit, detyrimet dhe tarifat e tij, si dhe për çmimin e kuotave të fondit të investimit, siç janë në datën e llogaritjes.

Dita e vlerësimit të aseteve të sipërmarrjes (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t), gjatë së cilës është llogaritur vlera neto e aseteve për kuota ose aksion.

KOMISIONET DHE SHPENZIMET

KOMISIONE HYRËSE DHE DALËSE TË NJËHERSHME

Komision hyrje: Shoqëria administruese nuk do ta ngarkojë anëtarin me komision të menjëhershëm hyrje në Fond. Investitori është subjekt i komisioneve bankare në rastin e kalimit të fondeve në llogarinë e Fondit në bankën depozitare.

Komision dalje: Shoqëria administruese nuk e ngarkon anëtarin me komision të menjëhershëm dalje nga Fondi. Investitori është subjekt i komisioneve në rastin e kalimit të fondeve nga llogaria e Fondit në llogarinë e kërkuar të klientit në një bankë të nivelit të dytë.

KOMISIONE / TARIFA TË VAZHDUESHME QË PAGUHEN NGA FONDI

TARIFA E ADMINISTRIMIT

Tarifa e kostos së administrimit të Fondit do të mbahet nga Vlera Netë e Aseteve të Fondit dhe do të jetë në masën 1% në vit. Tarifa e administrimit do të llogaritet në fund të çdo dite dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji, si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës. Tarifa ditore e kostos së administrimit do të llogaritet sipas formulës:

Tarifa vjetore e raportuar e administrimit $\times 1/365$

Tarifa e kostos së administrimit i zbritet të ardhurës bruto të realizuar nga asetet e fondit. Në këtë mënyrë investitorëve ju përket e ardhura neto.

Fondi do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave me kosto të tjera si më poshtë:

- tarifa që i paguhet bankës depozitare. Kjo tarifë përlogaritët në bazë ditore mbi vlerën neto të aktiveve pas zbritjes së tarifës administrimit.
- kostot e auditimit vjetor të fondit të cilat bazohet në kontratën e lidhur midis shoqërisë administruese dhe Auditorit, e cila aprovohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Këto kosto shpërndahen në bazë ditore.
- tarifat dhe kostot që i paguhen AMF-së për Fondin; Përlogaritjet do të bëhen ditore prej 0.05 % e vlerës së aseteve dhe do të rregullohen sipas rakordimit dhe rregullores përkatëse me AMF.
- kostot dhe komisione për shitblerje të aseteve të fondit, në të cilat përfshihen edhe komisionet për transaksionet e kryera me brokerat.
- kosto të komunikimit të ndryshimeve në prospekt dhe komunikimeve me investitorin.

Shpenzimet zbriten nga të ardhurat apo kapitali i SIK në bazë ditore dhe diferenca e cila ndryshon çmimin e kuotës shpërndahet në mënyrë proporcionale me numrin e kuotave në fond deri në momentin e përlogaritjes.

Shoqëria do të zgjedhë alternativën më të mirë mes trajtimit në ALSE dhe jashtë saj. Tarifa e kostonë së administrimit dhe kostot e tjera si më sipër listuar në një vit kontabël, nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5 % të vlerës neto të aseteve të fondit. Shoqëria mund të ndryshojë tarifat e Fondit në përputhje me ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020, "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij.

Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në prospektin e Fondit, i cili miratohet paraprakisht nga AMF dhe i njoftohet mbajtësve të kuotave menjëherë.

KOMISIONE / TARIFA QË PAGUHEN NGA INVESTITORI

Fondit nuk i ngarkohen kostot të cilat përballohen nga investitori, dhe listohen si më poshtë:

- kosto shërbimi për investitorin për lëshim certifikata dhe vërtetimesh të posaçme;
- kosto të transaksioneve bankare të pagesave për klientët;

Komisionet e marketimit dhe të shitjes do të paguhen nga Shoqëria Administruese.

Komisionet bankare të transferimit të fondeve nga shlyerja e kuotave janë pergjegjësi e investitorit. Shoqëria Administruese nuk mban pergjegjësi për komisionet bankare që shoqërojnë investimin apo daljen nga fondi. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për uljen e kostove të transferimit të fondeve me palët e përfshira në proces.

TRAJTIMI FISKAL

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.

Taksimi i Fondit bazohet në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në fond, do të tatohen sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Shoqëria Administruese mban në burim tatimin duke e zbritur nga fitimet kapitale nga investimi që u paguhet mbajtësve të kuotave.

Vlerësimi fiskal mund të ndryshojë si rezultat i ndryshimeve ligjore, akteve normative të dala nën zbatim

PROSPEKT

të tyre, si dhe vendimeve përkatëse të gjykatës. Referuar sa më sipër, ne u rekomandojmë investitorëve potencialë apo anëtarëve ekzistues të fondit, se përpara se të blejnë apo shesin kuota në fond, të këshillohen me një këshilltar fiskal mbi pasojat që mund të lindin sipas situatës së tyre personale.

BLERJA E NJË KUOTE

Kuotat do të ofrohen në treg nëpërmjet Shoqërisë Administruese, rrjetit të shpërndarjes së Bankës Credins, si dhe agjentëve që kanë lidhur kontratë me Shoqërinë Administruese për shërbimin e agjentit të fondit të investimeve. Listën e rrjetit të agjentëve të fondit “Credins Premium” e gjeni në adresën e publikuar të rrjetit të Shoqërisë, në rubrikën Fondi i Investimit/ Fondi Credins Premium/Informacion mbi Fondin.

Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare, ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie kontraktuale me Shoqërinë Administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Blerja e kuotave do të realizohet nëpërmjet dy mënyrave:

- 1) me kërkesë për blerje të menjëherëshme me një vlerë të menjëherëshme, duke lidhur kontratë për blerje të menjëherëshme.
Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr. AL98 2101 1012 0000 0000 0166 7197, në monedhën Lekë, të hapur pranë depozitarit, i cili është Banka Amerikane e Investimeve sh.a., në një nga mënyrat e mëposhtme:
Transferte nga llogaria e investitorit pranë Bankës Credins drejt llogarisë së Fondit (pa komision);
Pagesë në sportelet e agjentëve-institucione financiare dhe kalim drejtpërdrejt në llogari të Fondit pranë Bankës Depozitare;
Transferte nga llogaria e investitorit pranë çdo banke tjetër të nivelit të dytë (të ndryshme nga Banka CREDINS) drejt llogarisë së Fondit.
- 2) kërkesë për blerje kuotash në mënyrë periodike mujore, duke lidhur një kontratë për blerje me një vlerë fikse për cdo muaj. Përveç kësaj kontrate klienti lidh edhe një kontratë me bankën për kryerjen e një pagese periodike automatike, pra nëpërmjet aktivizimit të shërbimit të pagesave automatike pranë bankave të nivelit të dytë në mënyrat e mëposhtme:
 - Lidh kontratën e kalimit automatik pranë Bankës Credins, ku mundësohet kalimi automatik ditor nga llogaria e klientit për në llogarinë e Fondit të Investimit Credins Premium, për të gjithë klientët që kanë aktivizuar këtë shërbim.
 - Lidh kontratë pranë bankave të nivelit të dytë për kalim transferte automatike nga llogaria e klientit për në llogarinë e Fondit të Investimit Credins Premium, për cdo muaj.
 - Transferte periodike nga ana e klientit nga llogaria e klientit për në llogarinë e Fondit, ose transferte nëpërmjet e-banking.

Transferrat automatike janë të ekzekutueshme vetëm në rastin kur llogaria e urdhëruesit ka likuiditetin e nevojshëm.

Çdo investitor që dëshiron të blejë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë blerje, dhe do të



bëhet pronar i një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me ligjin nr. 56/2020, date 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt. Nëse kërkesa e blerjes regjistrohet gjatë fundjavës, ditë feste, blerja e kuotave do të bëhet me çmimin e ditës pasardhëse të punës. Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore. Asnjë kuotë nuk mund të blihet ose të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrit për blerjen ose shitjen e kuotave.

ADMINISTRIMI I PJESËS SË FITIMIT PËR MBAJTËSIT E KUOTAVE

Kuotat e fondit janë kuota akumulimi. Si të tilla, të ardhurat që gjeneron investitori nga investimi në kuotat e fondit, riinvestohen automatikisht, duke sjell akumulimin e fitimeve të investitorit, të cilat reflektohen në çmimin e kuotës që zotëron investitori.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

- E drejta për informacion (raporte vjetore, gjashtë-mujore etj);
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- E drejta për shlyerjen e kuotave në fondin e investimit;
- E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.
- E drejta për pajisjen me certifikatën e pronësisë për kuotat me kërkesë të investitorit brenda 7 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës.

Investitorët janë përgjegjës për detyrimet përkatëse deri në masën e përqindjes së tyre zotëruese në fond. Investitorët nuk janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

Aktivitetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që ka nën administrim një shoqëri administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi, si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar dhe as të shlyerjes apo ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit të kuotave të fondit. Depozitari i fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe veri-kon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Aktualisht Shoqëria Administruese nuk do të mundësojë transferimin e kuotave. Investitorët do të njoftohen për çdo ndryshim në vijim.

SHLYERJA E KUOTAVE

Mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre duke plotësuar dhe depozituar pranë Shoqërisë Administruese një kërkesë për shlyerje.

Shlyerja e kuotave në Fond bëhet me një çmim të zbatueshëm në datën e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje.

PROSPEKT

Kryerja e pagesës në asete monetare, nga llogaria e Fondit në llogarinë e investitorit do të bëhet brenda 7 ditëve kalendarike nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje në Credins Invest. Nëse kërkesa për shlyerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Çdo pagesë për fondin e investimit bëhet në asete monetare dhe, vetëm në rrethana të veçanta, të parashikuara nga një rregullore e AMF-së, në tituj apo asete të tjera, kur është i mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë.

Shlyerja e kuotave, duke përdorur asete të fondit, ose shlyerja me anë të transferimit të një përqindjeje përkatëse të çdo lloji asetesh të fondit me një vlerë, e cila barazon vlerën e kuotave për t'u shlyer në këtë mënyrë, lejohet në rastet kur shitja e asetëve të fondit, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të komprometojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në fond, me kusht që prospekti i tij të përshkruajnë mënyrën e shlyerjes së kuotave në këtë formë. Shlyerja me asete mund të bëhet vetëm duke transferuar atë pjesë të çdo lloji asetesh të fondit, e cila është në përpjesëtim me numrin e kuotave të investitorëve, që kërkojnë shlyerjen dhe vlerën totale të asetëve të fondit.

PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE TË FONDIT

Shlyerja e kuotave të Fondit mund të pezullohet në rastet kur:

1. Shoqëria administruese dhe depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme ka arsye të forta e të justifikuar, për pezullimin e shlyerjes, në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë.
 - Nëse shoqëria administruese pezullon shlyerjen e kuotave në të njëjtën kohë duhet të pezullojë edhe shitjen e kuotave.
 - Nëse Shoqëria Administruese merr vendim për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave dhe nëse depozitari nuk është dakord me një vendim të tillë, ky i fundit njofton menjëherë Autoritetin.
 - Shoqëria Administruese, në çdo rast, i njofton menjëherë AMF-së vendimin për pezullim të shitjes dhe shlyerjes së kuotave AMF, së bashku me një informacion orientues se kur do të rifillojë shlyerja.
2. AMF mund të urdhërojë Shoqërinë Administruese dhe depozitarin të pezullojë përkohësisht shlyerjen dhe shitjen e kuotave nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave.

Shoqëria Administruese publikon menjëherë të dhënat për çdo pezullim të shitjes dhe shlyerjes së kuotave, në faqen e saj zyrtare të internetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së pezullimit.

Pas marrjes së njoftimit nga Shoqëria Administruese për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave, AMF mund të urdhërojë anulimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në fond.

Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve pune nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur autoriteti ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati. Shoqëria administruese informon autoritetin menjëherë me të rifilluar shitjen dhe shlyerjen dhe rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga shoqëria administruese në faqen e internetit të shoqërisë administruese.



KËMBIMI I KUOTAVE

Mbajtësi i kuotave në një fond investimi mund të këmbëjë kuotat e tij me kuota në një fond tjetër të administruar nga e njëjta shoqëri administrimi, përveçse gjatë periudhës kur e drejta për shlyerje është pezulluar (sipas përcaktimeve në seksionin “Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondit”).

Këmbimi i kuotave bëhet duke iu referuar çmimit të kuotave në momentin e vlerësimit. Numri i Kuotave të reja të blera do të përcaktohet duke iu referuar çmimeve përkatëse të Kuotave të Reja dhe Kuotave fillestare në momentin e vlerësimit.

Shoqëria nuk do aplikojë komisione për këmbimin e kuotave.

VDEKJA E ANËTARIT

Nëse anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjitha asetëve të veta, asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

MBYLLJA E FONDIT

Rrethanat e mbylljes

Fondi i Investimit mund të likuidohet në mënyrë vullnetare kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin Nr.56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”; ose në momentin e heqjes të licencës nga AMF.

Fondi i investimeve kolektive me oferte publike, kur ka aftësi paguese, mund të likuidohet edhe në mënyrë vullnetare:

- kur shoqëria administruese bën kërkesë për likuidim, sepse fondi i investimeve nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe nuk përmbush qëllimin e tij;
- në rast të përfundimit të detyrave të depozitarit ose shoqërisë administruese të fondit të investimeve, nëse ato nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune;
- në rast të falimentimit të shoqërisë administruese;
- në përfundim të procesit të bashkimit, kur fondi i investimeve që bashkohet mbetet pa aktive, pasi i ka transferuar ato tek fondi marrës i investimeve;

Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve

Në rastin e likuidimit vullnetar, Shoqëria njofton AMF-në të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së propozuar të likuidimit.

Kërkesa që i paraqitet autoritetit për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve ka në përmbajtje arsyet e kërkesës dhe një plan kohor për likuidim.

Mbajtësit e kuotave informohen lidhur me likuidimin vullnetar pas dhënies së miratimit nga autoriteti. Informacioni që u vihet në dispozicion mbajtësve të kuotave, përfshin:

- arsyet e likuidimit;
- pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;
- kostot përkatëse;
- pasqyrat e aftësisë paguese;
- datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së aksioneve ose kuotave.

Mbyllja e Fondit të Investimit realizohet nga shoqëria administruese që administron Fondin.

PROSPEKT

Procedurat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen e fondit

Në rastin e mbylljes së fondit si rrjedhojë e transferimit të aktiveve tek marrës i investimeve, për shkak të bashkimit, zbatohen procedurat e mëposhtme:

- a) njoftimi i mbylljes ose likuidimit vullnetar u dërgohet menjëherë mbajtësve të kuotave, nëse nuk është bërë ky njoftim;
- b) ndërpritet vlerësimi dhe vendosja e çmimit;
- c) fondi i investimeve pushon së emetuari ose anuluar kuota, me përjashtim të anulimit përfundimtar;
- ç) nuk regjistrohet asnjë transferim kuote dhe asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në regjistrin e mbajtësve të kuotave pa sanksionimin e shoqërisë administruese dhe depozitarit;
- d) fondi i investimeve nuk ushtron asnjë lloj veprimtarie, me përjashtim të veprimtarisë së mbylljes;
- dh) përgjegjësitë dhe detyrimet e shoqërisë administruese vijojnë të zbatohen deri në përfundim të mbylljes;
- e) shoqëria administruese kryen veprimet për arkëtimin e pasurisë së sipërmarrjes dhe shlyerjen e pasiveve të sipërmarrjes me fondet e arkëtuara, sa më shpejt të jetë e mundur pasi të ketë filluar mbyllja;
- ë) shoqëria administruese udhëzon depozitarin mbi mbajtjen e fondeve të arkëtuara, sipas shkronjës “e”, të kësaj pike (deri në përdorimin për të shlyer pasivet ose në shpërndarjen e mbajtësit të kuotave) dhe këto udhëzime përgatiten, me qëllim mbrojtjen e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave nga humbja.

Pas marrjes së vendimit për mbyllje, çdo shitje e mëtejshme ose shlyerje e kuotave në Fondin e investimit është e ndaluar, përveçse në rastet e kërkesave të marra pas përcaktimit më të fundit të çmimit dhe para marrjes së vendimit për mbyllje.

Nga data e marrjes së vendimit për mbyllje, nuk ngarkohet asnjë tarifë mbi Fondin. Likuiduesi është i detyruar t'i paraqesë AMF-së raportet për ecurinë dhe raportet përfundimtare të mbylljes, si dhe është përgjegjës për përgatitjen e raporteve të kërkuara.

Gjatë procedurës së mbylljes, veprimtaria e biznesit në vijim do të ndërpritet. Transaksionet me asetet e Fondit do të lejohen vetëm për qëllimet e mbylljes së Fondit. Në këtë mënyrë, shiten të gjitha asetet e Fondit, si dhe paguhen detyrimet e tij, të kërkueshme deri në datën e marrjes së vendimit për mbyllje. Pjesa e mbetur e vlerës neto të aseteve të Fondit u shpërndahet mbajtësve të kuotave në përpjesëtim me pjesën e tyre në Fond.

Afati kohor për të realizuar mbylljen e një Fondi Investimi do të jetë deri në 12 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së vendimit për mbylljen e Fondit. Në rastin kur likuiduesi vendos që është në interesin e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave për të shtyrë këtë afat, Autoriteti mund të miratojë shtyrjen e afatit kohor për realizimin e procedurave të mbylljes edhe për maksimumi 6 (gjashtë) muaj të tjerë.

DEPOZITARI

Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. me seli në Rr. e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, e liçencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitarit dhe të besimit, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e investimit me Vendimin nr. 92 datë 03.07.2017. Funkzioni kryesor i Depozitarit është ruajtja e aseteve të Fondit, dhe veprimi në interesin më të mirë të mbajtësve të kuotave.



Përveç ruajtjes së aseteve të Fondit, depozitari kryen edhe veprimtaritë e mëposhtme:

1. garanton, që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave të realizuara për llogari të fondit të investimit të shoqërisë administruese, janë kryer në përputhje me ligjin;
2. garanton që llogaritja e vlerës neto të aseteve të aksioneve ose të kuotave në fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin;
3. përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me ligjin dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti ose me aktin themelues të sipërmarrjes;
4. garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes, brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e sipërmarrjes;
5. zbaton urdhrat e shoqërisë administruese për transaksionet, që përfshijnë titujt dhe asetet e tjera që përbëjnë portofolin, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj, me rregulloret e AMF-së, prospektin dhe bën të mundur realizimin dhe kryerjen e transaksioneve me titujt, që do të thotë se detyrimet monetare janë arkëtuar brenda kufijve kohorë, ligjorë ose kufijve kohorë të miratuar nga palët;
6. mban regjistrin e mbajtësve të kuotave;
7. i raporton shoqërisë administruese për veprimet e shoqërisë për asetet e Fondit, të cilat i ruan në formë të shkruar ose elektronike dhe, në vijim, zbaton urdhrat e saj;
8. garanton që flukset monetare të sipërmarrjes monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe se të gjitha mjetet monetare të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të sipërmarrjes, shoqërisë administruese për llogari të sipërmarrjes ose të depozitarit për llogari të sipërmarrjes;
9. lidhur me llogaritë e hapura te pikes 8, depozitari merr masat e nevojshme për të siguruar që fondet e sipërmarrjes SIK të depozituara pranë një banke qendrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër ose në një fond të tregut të parasë të SIK mbahen në një llogari ose disa llogari të identifikuara më vete nga çdo llogari e përdorur për të mbajtur fondet që i përkasin depozitarit apo fondeve a klientëve të tjerë të depozitarit.
10. siguron se fitimi i Fondit përdoret në përputhje me këtë ligj, me prospektin dhe se të gjitha kostot e paguara nga Fondi janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në prospekt;
11. kryen veprimtari të tjera profesionale ose administrative, sipas parashikimeve në kontratën
12. ndërmjet tij dhe shoqërisë administruese ose këshillit të administrimit;
13. mban, për çdo Fond të veçantë, evidenca dhe regjistrime për kryerjen e veprimtarisë si depozitar dhe i rakordon këto të dhëna me të dhënat e evidencave dhe të regjistrimeve të shoqërisë administruese;
14. i raporton AMF-së për çdo shkelje të këtij ligji dhe të kontratës nga shoqëria administruese, në rast se kjo shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje;
15. me kërkesë të AMF-së, siguron çdo lloj informacioni për asetet, që mban për një sipërmarrje kolektive investimi, përfshirë, por pa u kufizuar, të dhëna, që provojnë ekzistencën e aseteve.
16. arkëton të ardhurat dhe përfitimet e tjera përkatëse në dobi të Fondit dhe që u bashkëngjiten aseteve të tij;
17. u siguron akses në të dhënat dhe llogaritë kontabël, që lidhen me fondin dhe asetet e tij, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe personave të tjerë të autorizuar për kontroll, përfshirë dhe AMF-në;

Aktivitetet e fondit të investimeve, që mban depozitari veçohen dhe nuk përfshihen në aktivet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe as për shlyerjen apo ekzekutimin e pretendimeve kundrejt depozitarit të fondeve të investimeve alternative ose kundrejt depozitarit.

PROSPEKT

KONFLIKTI I INTERESIT

Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me SIK me oferte publike ose me shoqërinë administruese të SIK kur këto veprimtari shkaktajnë konflikt interesi. Përjashtim bën rasti kur depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme.

Shoqëria e licencuar si depozitar, gjithashtu, nuk zotëron licencë si shoqëri administruese, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila mund të ketë licencë si shoqëri administruese e fondeve. Shoqëria e licencuar si depozitar nuk mund të jetë e licencuar si shoqëri investimesh.

Kur depozitari kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se:

- a) identifikohen të gjitha konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione;
- b) ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i shmangur këto konflikte interesi.

Kur nuk mund të shmanget konflikti i interesit, shoqëria administruese dhe depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të investitorëve të saj.

Investitorëve i vihet në dispozicion, sipas kërkesës informacione të përditësuara në lidhje me identitetin, funksionet e depozitarit si dhe konflikteve të interesit që mund të lindin.

AUDITUESI

Audituesi i jashtëm i Shoqërisë dhe Fondeve nën administrim është Grant Thornton Albania, me status aktiv në regjistrin e audituesve ligjorë të regjistruar pranë IEKA.

Seli në adresën: Njësia bashkiake nr. 5, Rr. "Sami Frasheri", Kompleksi TID Shkalla B, Kati 1 Tirana, 1001, Tiranë.

Tel : +355 44 525 880

Mobile: +355 69 4014 701

E-mail: contact@al.gt.com

Website: www.grantthornton.al

Personat Pergjegjës:

Z. Kledian Kodra - Partner

Z. Fatjan Devija - Senior Manager

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

AMF

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbikëqyr Shoqërinë Administruese dhe Depozitarin.

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Fondit konsiderohet viti kalendarik.

Çdo ndryshim i prospektit do të miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.



INFORMACION PLOTËSUES

Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare

Shoqëria “Credins Invest” nën cilësinë e Institucionit Financiar Jobankar, në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, në marrëdhënie me investitorët, duhet të raportojë pranë autoriteteve tatimore të Republikës së Shqipërisë të dhëna të Investitorëve me rezidencë tatimore në një nga shtet anëtare të CRS-së, të cilat më pas i shkëmbejnë me autoritetet tatimore të vendit të rezidencës së deklaruar nga Investitori. Për sa më sipër, të gjithë Investitorët ekzistues ose që duan të hapin një llogari të re, u kërkohet të plotësojnë një formular Vetë deklarimi me të dhënat e tyre personale dhe tatimore, si dhe numrin përkatës të identi-kimit për qëllime fiskale.

FATCA

FATCA (Foreign Account Tax Compliance ACT) Ligji për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja është legjislacion amerikan që ka hyrë në fuqi në 1 Korrik 2014. FATCA kryesisht është një kërkesë rregullatore kundrejt institucioneve të huaja financiare për të raportuar llogaritë financiare të mbajtura nga taksapaguesit amerikanë, ose nga subjektet e huaja në të cilat tatimpaguesit amerikanë kanë një interes të konsiderueshëm pronësie.

Shoqëria “Credins Invest” njih rëndësinë e FATCA dhe është në përputhje me kërkesat saj. Bazuar në kërkesën e Investitorëve, Shoqëria Administruese do të njoftojë këta të fundit për numrin Unik GIIN për qëllime raportimi në FATCA.

ANEKS 1



KONTRATË PËR BLERJEN E KUOTAVE NE FONDIN E INVESTIMIT “CREDINS PREMIUM”

TË DHËNAT E INVESTITORIT

Emër Atësia Mbiemër _____ Shtetësia _____
Nr. Personal _____ (bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit),
Data e lëshimit: _____, Data e skadimit: _____, Shteti ku paguan taksat: _____
Datëlindja _____, Vendlindja _____
Adresa Vendbanimit _____
Adresa korrespondencës: _____
Kodi Postar _____, Tel/Cel _____, E-mail _____
Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj) _____
Nr. i lejes së qëndrimit në Shqipëri, _____ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)
Pozicioni i punës: _____, I punësuar _____

TË DHËNAT E PERSONIT TË TRETË QË INVESTON NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË INVESTITORIT

Emër Atësia Mbiemër _____ Shtetësia _____
Nr. Personal _____ (bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit),
Data e lëshimit: _____, Data e skadimit: _____, Shteti ku paguan taksat: _____
Datëlindja _____, Vendlindja _____
Adresa Vendbanimit _____
Adresa korrespondencës: _____
Kodi Postar _____, Tel/Cel _____, E-mail _____
Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj) _____
Nr. i lejes së qëndrimit në Shqipëri, _____ (kopja e të cilës i bashkëlidhet kontratës)
Pozicioni i punës: _____, I punësuar _____

MËNYRA E INVESTIMIT

Shuma e investuar _____ mënyra e pagesës _____
Nr. Llogarisë së Depozitarit _____
Burimi i të ardhurave _____

Deklaroj nën përgjegjësi time se burimi i fondeve, është nga një aktivitet i ligjshëm dhe njëkohësisht investimi i tyre do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme.

Pagesë e Menjëhershme

Plan Investimi Pagesa e parë në plan investimi _____

Frekuenca e zgjedhur e pagesave: Mujore, Tremujore, 6-Mujore, Në vit.

Kohëzgjatja e parashikuar e investimit (në muaj): _____

Investitorët në Fond janë të këshilluar që të qëndrojnë të paktën 2 vite nga investimi fillestar për shkak të veçorive të aseteve të Fondit. Nëse keni një plan më të shkurtër investimi, ju lutem specifikoni kohëzgjatjen e parashikuar në fond.

DEKLARATAT E INVESTITORIT

Nën cilësinë e Investitorit të Fondit të investimit "Credins Premium":

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam marrë, kam lexuar dhe kuptuar, si dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, Prospektin, dokumentin "Informacioni Kryesor për Investitortin" (KID), si dhe tarifat e aplikuara nga Credins Invest sh.a. - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Deklaroj se jam informuar, kam kuptuar profilin tim të riskut dhe marr përsipër rreziqet e përfshira.

Deklaroj se jam informuar se:

- o Fondi i Investimit nuk është depozitë dhe nuk është i siguruar pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD).
- o Kthimi nga investimi nuk përbën garanci/premtim.
- o Investimi në Fondi i Investimit nuk është një investim i garantuar.
- o Fondi i Investimit nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve.
- o Reziku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë kontratë është i vërtetë dhe i saktë. Është detyrimi im të përditësoj këto të dhëna, sa herë që do të ndryshohen nëpërmjet aksesit online apo një kërkesë me shkrim drejtuar shoqërisë administruese.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Deklaroj se jam në dijeni se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë kontratë si dhe/ose në çdo dokument tjetër (formular/pyetësor/deklaratë dhe jo vetëm) të nënshkruar apo deklaruar pranë Credins Invest do të përpunohen nga kjo e fundit me standartet me të larta të sigurisë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Unë shpreh pëlqimin tim që Credins Invest sha, të mbledhë të dhënat e mia personale të deklaruara nga ana ime, si edhe t'i përpunojë me tej ato vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për të cilin po aplikoj. Gjithashtu, deklaroj dhe jap miratimin tim për procesimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Credins Invest sha, duke i transferuar këto të dhëna drejt palëve kontraktore të cilat mund të jenë në cilësinë e përpunuesit në kuadër, të çeljes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë. Në këtë kuadër, jam njohur me faktin që të dhënat e mia personale i transferohen Depozitarit të Fondit të Investimeve bazuar në Ligjin nr 56/2020, "Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive", subjektit Credins Bank Sha, Shqipëri, në mënyrë që shoqëria të ushtrijë vigjilencën e duhur si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Autorizoj në mënyrë të shprehur Credins Invest sha, që të ruajë të dhënat e mia personale për një afat deri në 5 vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë. Gjithashtu, jam informuar se bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, unë mund të ushtroj në çdo kohë të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale që përpunohen nga ana e Credins Invest sha. Gjithashtu në çdo kohë ruaj të drejtën për t'u ankuar tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale" dhe ruaj të drejtën për t'u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunim e të dhënave.

Miratimi për përpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promovionale.

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Credins Invest sh.a., të përdorë të dhënat e mia personale për qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promovionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që Shoqëria ofron (apo do të ofrojë në të ardhmen), nëpërmjet një ose disa prej kanaleve të informimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare ii) sms iii) telefonatë iv) postë elektronike etj. Në këtë kuadër autorizoj Credins Invest sh.a., që duke respektuar standartet me të larta të sigurisë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia personale, duke i transferuar këto të dhëna tek palë të treta të specializuara për këtë qëllim. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

Unë pranoj

Unë nuk pranoj

TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria Administruese e Fondeve është shoqëri e krijuar në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar dhe është regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr.34260, datë 31/10/2005, rilicënsuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr.85, datë 30/05/2016, me seli në adresën: Rr. "Nikolla Tupë" Nr.1, Kat 2, Tiranë, përfaqësuar nga znj.Estela KOÇI, Administrator i Përgjithshëm. Nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të CREDINS INVEST sh.a., deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se investimi i kontributeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.

Data e lidhjes së kontratës _____,

Vendi _____

INVESTITORI / PALA E TRETË

Shoqëria Administruese e Credins Invest sh. a. përfaqësuar nga

Neni 1 OBJEKTI

1. Objekt i kësaj kontrate është të rregullojë marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Investitorit dhe Credins Invest sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve (këtu e në vijim “Shoqëria Administruese”).
2. Marrëdhëniet kontraktuale të dyanshme, të përmendura në pikën 1, rrjedhin nga pjesëmarrja dhe investimi në Fondin e investimit “Credins Premium” (këtu e në vijim “Fondi”), me qëllim investimin e aseteve dhe ofrimin e përfitimeve tek:
 - i. investitorët prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.
 - ii. mbajtësit e kuotave (këtu e në vijim investitorët) si shpërndarje periodike e ardhur nga investimi i vlerës së këtyre kuotave.

Neni 2 SUBJEKTET E KONTRATËS

1. Subjekte të kësaj kontrate janë individ, i cili gëzon zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar apo i huaj, i cili me pëlqimin e vet (ose të përfaqësuesit të tij ligjor) bëhet investitor në Fond, si dhe Shoqëria Administruese, e cila në respektim të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi ofron shërbimet e fondit të investimit, nëpërmjet kuotave në një fond investimi.
2. Subjektet e kësaj kontrate janë çdo person fizik ose juridik, i cili me pëlqimin e vet bëhet investitor në Fond, (mbajtës kuotash) si dhe Shoqëria Administruese, e cila në respektim të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi ofron shërbimet e fondit të investimit, nëpërmjet kuotave në një fond investimi.

Neni 3 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si Kodin Civil, ligjin nr.56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese.

Neni 4 PËRKUFIZIME

Termet e përdorur në këtë Kontratë kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, dhe në prospektin bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 5 INVESTIMI NË FOND

1. Mund të investojë në këtë Fond çdo individ; person fizik apo juridik, i cili me pëlqimin e tij bëhet investitor i fondit të investimit dhe lidh këtë kontratë me Shoqërinë Administruese për të përfutur shërbimet e fondit të investimit.
2. Është pjesë përbërëse e kësaj kontrate formulari standart i aplikimit, i cili përmban deklaratën e investitorit. Duke e nënshkruar këtë deklaratë investitori, pranon kushtet e kontratës, si dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin e Shoqërisë Administruese.

Neni 6 VLERA FILLESTARE E KUOTËS

1. Kuota e investitorit në këtë fond investimi, do të jenë aset i tij në fond dhe do të jenë të emetuara në monedhën lekë. Shuma minimale e investimit në kuotë do të jetë jo më pak 2,000 (dy mijë) lekë. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në fond, llogaritur në përputhje me ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe prospektin e fondit të investimit Credins Premium.
2. Proçedura e blerjes së kuotave nga investitori, përcaktohet në prospektin e Shoqërisë Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi (mbajtës kuotash); sipas kësaj kontrate pas blerjes së kuotave, ka përcaktuar detyrimet kontraktuale me shoqërinë administruese. Shoqëria administruese sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, ligjit, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij është e detyruar të administrojë asetet e paguara; si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me

kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt. Blerja e kuotave nga blerësi (mbajtës kuotash); mund të kryhet edhe duke shpërndarë kuota të reja në bazë të shpërndarjes së pjesës në fitim, domethënë kur vlera e kuotave zvogëlohet në bazë të dhënies së kuotave të reja, ose në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret që miraton autoriteti mbikëqyrës (AMF). Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Neni 7 POLITIKA E INVESTIMIT

1. Investimi i aseteve të Fondit synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t'u siguruar investitorëve të Fondit përfitime të larta nga investimi i kuotave.
2. Karakteristikat e Fondit dhe të politikës së investimeve janë paraqitur në prospektin e bashkëlidhur kësaj kontrate.
3. Investitori (mbajtës kuotash), pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin, merr përsipër riskun e investimit të Fondit. Çmimi i një kuote dhe e ardhura nga investimi mund të ulet apo të ngrihet dhe nuk ka garanci për një normë kthimi të paracaktuar.
4. Shuma e akumuluar në Fond nuk është e garantuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).
5. Çdo ndryshim i politikës së investimit, do t'u njoftohet mbajtësve të kuotave nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të shoqërisë administruese, si dhe u dërgohet me postë elektronike brenda gjashtëdhjetë ditëve pune përpara ditës së implementimit të ndryshimeve

Neni 8 DEPOZITARI

1. Shoqëria Administruese, ka lidhur një kontratë me Banka Amerikane e Investimeve sh .a., me seli në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiake Nr.10 Kodi Postar 1001, Tiranë, e cila në përputhje me ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, do të ofrojë shërbimet e Depozitarit për asetet e Fondit.
2. Depozitari në këtë kontratë, nënkupton bankën e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit. Depozitari gëzon cilësinë e entitetit tërësisht të pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër të lidhur me të. Depozitari siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të investimit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.
3. Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve të fondit të investimit dhe të aseteve të investitorëve në Fond.
4. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit, si dhe të legjislacionit në fuqi.
5. Depozitari siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të investimit, t'i kthehet fondit të investimit çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara.

Neni 9 MBROJTJA E ASETEVE TË FONDIT TË INVESTIMIT

Asetet e fondit të investimit, që mban depozitari, të depozituara në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, veçohen dhe nuk përfshihen në aktivet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe as për shlyerjen apo ekzekutimin e pretendimeve të të tretëve kundrejt depozitarit. Asetet e fondit të investimit duhet të veçohen nga asetet e depozitarit, në bazë të së drejtës së veçimit në proçedurë falimentimi dhe nuk përfshihen në shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve të depozitarit.

Neni 10 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese në kuadër të kësaj kontrate ka detyrën kontraktuale:

- a) Të administrojë me efektivitet asetet e investitorëve në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e asetëve të investitorëve.
- b) Të ofrojë përfitime nga investimi dhe përfitime të tjera (këtu nënkuptohen përfitimet e parashikuara në nenin 109 dhe 113 i ligjit nr.56/2020), tek investitorët, sipas kushteve dhe procedurave ligjore.
- c) Të informojë çdo investitor lidhur me prospektin e Shoqërisë Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën.
- d) Shoqëria Administruese do të mundësojë pajisjen e investitorëve me emër përdoruesi dhe fjalëkalim, për të kontrolluar transaksionet, gjendjen në Fond dhe informacione të tjera nëpërmjet Web-it.
- e) Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo investitori dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek investitorët e Fondit, personat e autorizuar nga investitori, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji.
- f) Të informojë në çdo kohë investitorët për sa i përket ndryshimeve në politikat e investimit, si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për investitorët.
- g) Të kryejë këmbimin e asetëve, mbështetur në kërkesën me shkrim të investitorit, në një Fond tjetër të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese.
- h) Të kryejë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të asetëve në llogarinë e mbajtësit të kuotave apo investitorit që i përgjigjen kësaj vlere, mbështetur në kërkesën me shkrim të investitorit, sipas kontratës.

Neni 11 GARANCITË

Aktivitetet e Fondit të Investimit, që ka nën administrim një shoqëri administruese, nuk do të jenë objekt ekzekutimi, si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar dhe as të shlyerjes apo ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

Neni 12 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT

1. Investitori i fondit të investimit, sipas kësaj kontrate, ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a) Të ketë pronësinë e asetëve të investuara në Fond;
 - b) Të marrë pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
 - c) Të posedojë certifikatën e blerjes së kuotave të fondit jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës;
 - d) Të këmbëjë kuotat e veta me kuota në një fond tjetër të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, sipas zgjedhjes së tij përveçse gjatë periudhës kur e drejta për shlyerje është pezulluar;
 - e) Të përfitojë paratë e kuotave të shlyera të fondit jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e marrjes së një kërkesë të vlefshme sipas kushteve dhe procedurave ligjore.

Neni 13 PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Investitori i fondit të investimit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të asetëve në llogarinë e tij sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109,

110, 111, 112, 113, 114 të ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

2. Pagesa e vlerës së kuotave, do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Investitorit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 7 ditë nga marrja e kërkesës.

Neni 14 SHLYERJA E KUOTAVE TE FONDIT TE INVESTIMIT

Investitori, sipas zgjedhjes, ka të drejtë që të kërkojë shlyerje të kuotave të investimit sipas çmimit të zbatueshëm në bazë të prospektit të Fondit të Investimit dhe rregulloret të nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kohën e marrjes së kërkesës së vlefshme për shitje.

Neni 15 PAGESA E ASETËVE NË RASTIN E VDEKJES SË INVESTITORIT

Në rastin kur Investitori vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë kuotave/asetëve të veta, kuotat në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, që rregullojnë trashëgiminë.

Neni 16 TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

1. Tarifat, kostot dhe komisionet e shoqërisë administruese janë të paraqitura në mënyrë analitike në dokumentin “Prospekt” dhe në dokumentin “Informacioni Kryesor për Investitorin” (KID), bashkëlidhur kësaj kontrate.
2. Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t’u njoftohet mbajtësve të kuotave nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të shoqërisë administruese, si dhe u dërgohet me postë elektronike brenda gjashtëdhjetë ditëve pune përpara ditës së implementimit të ndryshimeve.

Neni 17 KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasoja ligjore vetëm pasi, të jetë kryer pagesa e parë e kuotës në fondin e investimit, sipas metodës së rënë dakord mes palëve. 2. Kontrata e fondit të investimit, do të përfundojë:
 - a) Në rastin e shlyerjes së kuotave të Investitorit të Fondit;
 - b) Në rastin e vdekjes së Investitorit të Fondit.

Neni 18 GJYKATA KOMPETENTE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi mes palëve, ato gëzojnë të drejtën t’i adresohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Gjykatës së Rrethit, Tiranë.

Neni 19 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Në të gjitha rastet që kërkohet nga ligji, ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptimin e palëve nënshkruese të saj.
2. Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në tre kopje identike.

INVESTITORI/PALA E TRETË

**Shoqëria Administruese Credins Invest sh.a.
përfaqësuar nga**

ANEKS 2

DEKLARATA E KUJDESTARISË

Bazuar në Ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” nën cilësinë e Depozitarit të Fondit të Investimit “Credins Premium”,

Deklaroj se:

Pasuria e Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive, do të ruhet nga Depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor.

Shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t’u shpërndarë, mbahen nga Depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje.

Monedha bazë e Fondit është Lek.

Viti Financiar i Fondit është viti kalendarik Janar – Dhjetor.

Deklaroj se Depozitari do të jetë ushtrrojë aktivitetin e tij në përputhje me sa më poshtë:

Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me SIK me oferte publike ose me shoqërinë administruese të SIK kur keto veprimtari shkaktojnë konflikt interesi. Depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme.

Shoqëria e licencuar si depozitar, gjithashtu, nuk zotëron licencë si shoqëri administruese, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila mund të ketë licencë si shoqëri administruese e fondeve. Shoqëria e licencuar si depozitar nuk mund të jetë e licencuar si shoqëri investimesh.

Kur depozitari kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se:

- a) identifikohen të gjitha konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione;
- b) ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për t’i shmangur këto konflikte interesi.

Kur nuk mund të shmangët konflikti i interesit, shoqëria administruese dhe depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të investitorëve të saj.

Depozitari: Banka Amerikane e Investimeve (ABI) sh.a.

Përfaqësuar nga

Z. Andi BALLTA

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Credins Invest, Zyra Qendrore
Rr. "Nikolla Tupe", Nr.1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri

www.credinsinvest.com
contact@credinsinvest.com

Tel: +355 69 60 60 058
Nuis: K52311009R

